



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 35 (827991)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 4 shtator 2026



MBI 1500 EFEKTIVË NË VIJËN E PARË TË ZJARREVE

» faqe 3



STËRVITJE, NDËRVEPRUESHMËRI, ALEANCË. KONTINGJENTI VIII I REGJIMENTIT TË KËMBËSORISË SË VERIUT ZHVILLON STËRVITJE TË PËRBASHKËT ME TRUPAT ITALIANE NË NOVO SELO

Novo Selo, Bullgari – Stërvitja e përbashkët, bashkëpunimi dhe ndërveprueshmëria janë në themel të gatishmërisë së forcave aleate. Në këtë kuadër, Kontingjenti VIII i trupave të Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut (RKV), i dislokuar në Novo Selo, Bullgari, në kuadër të misionit të NATO-s Forward Land Forces (FLF), zhvilloi një stërvitje të përbashkët me personelin italian...

faqe 3



ARBËR GJOKA: TRANSPORTI ËSHTË SHTYLLA QË I MUNDËSON FORCËS TË MOS NDALE KURRË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Komandanti i Batalionit të Transportit: Nga përvoja e viteve të modernizimi i flotës, nga misionet në Kosovë e emergjencat civile të sfidat e reja të Forcave të Armatosura.

faqe 6



BILBIL BITRI, GJENERALI SHQIPTAR NË KRYE TË NJË BRIGADE SHUMËKOMBËSHE

Karriera e ushtarakut nuk është thjesht një detyrë e përfunduar, është një jetë që merr kuptim përtej individit dhe bëhen pjesë e historisë së një institucioni, të një ushtrie dhe të një vendi. Për Gjeneralin Brigade Bilbil Bitrin, ceremonia e zhvilluar në Stamboll, me rastin e zhvendosjes së Shtabit të Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG)...

faqe 6

Kolonel Vladimir Jaupi merr drejtimin e Qendrës së Personel Rekrutimit

Një kapitull i ri përgjegjësish në menaxhimin dhe përzgjedhjen e burimeve njerëzore të Forcave të Armatosura

Kolonel Vladimir Jaupi ka marrë detyrën e Komandantit të Qendrës së Personel Rekrutimit, duke nisur një kapitull të ri përgjegjësish në një prej strukturave më të rëndësishme për të ardhmen e Forcave të Armatosura. Qendra e Personel Rekrutimit ka një rol të drejtpërdrejtë në identifikimin, përzgjedhjen dhe orientimin e burimeve njerëzore që synojnë t'i bashkohen Forcave të Armatosura. Në këtë kontekst, drejtimi i saj kërkon jo vetëm përvojë ushtarake, por edhe njohuri të menaxhimit të personelit, aftësi organizative dhe përgjegjësi të lartë institucionale. Me një karrierë mbi tri dekada në strukturat e Forcave të Armatosura, Kolonel Jaupi sjell në këtë detyrë një përvojë të konsoliduar në fushën e personelit, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe drejtimit të strukturave ushtarake.

Një karrierë e ndërtuar hap pas hapi

Kolonel Vladimir Jaupi ka nisur rrugëtimin e tij ushtarak në vitin 1994, pas studimeve në Akademinë “Skënderbej”. Detyra e tij e parë ishte ajo e komandantit të togës, duke vijuar më pas me funksione të ndryshme në strukturat e Forcave të Armatosura. Në vitin 1996 shërbeu si Shef Personeli, duke nisur kështu një profil të rëndësishëm të karrierës së tij në fushën e menaxhimit të personelit. Në vitin 2007 u angazhua si Specialist i Fondit të Oficerëve, ndërsa në vitin 2010 rikthehet në detyrën e Shefit të Personelit. Në vijim, në vitin 2014, shërbeu si Oficer Shtabi, ndërsa në vitin 2023 mori detyrën e Shefit të Degës.

Përvoja e akumuluar në këto funksione e ka përgatitur për përgjegjësi të mëtejshme drejtuese, duke kulmuar në vitin 2026 me marrjen e detyrës së Komandantit të Qendrës së Personel Rekrutimit.

Formimi profesional dhe akademik

Formimi i Kolonel Jaupit është ndërtuar përmes një kombinimi të arsimit ushtarak, kurseve të specializuara dhe studimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ai ka përfunduar Shkollën e Mesme të Bashkuar “Zoi Vangjeli”, Starovë, në vitin 1990, ndërsa në vitin 1994 ka vijuar studimet në Akademinë “Skënderbej”. Në vitin 2009 ka përfunduar Kursin njëvjeçar KDS, ndërsa në vitin 2012 ka ndjekur Kursin Funksional për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Forcat e Armatosura. Në vitin 2020, ai ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, duke konsoliduar më tej formimin e tij profesional dhe akademik.



Njohja e gjuhëve të huaja

Në funksion të përvojës së tij profesionale dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, Kolonel Jaupi është njohës i gjuhës angleze, italiane dhe turke. Kjo përbën një tjetër element të rëndësishëm të profilit të tij profesional, veçanërisht në një mjedis ushtarak ku bashkëpunimi ndërkombëtar dhe komunikimi me partnerët janë pjesë e rëndësishme e veprimtarisë institucionale.

Vlerësime për shërbimin ushtarak

Gjatë karrierës së tij, Kolonel Vladimir Ushtar Jaupi është

vlerësuar me medalje dhe tituj për kontributin dhe shërbimin e tij në Forcat e Armatosura, ndër të cilat: **MM-PSHSH. KF-MK.KF-MSH. KFMK15.** Këto vlerësime janë pjesë e rrugëtimin të tij profesional dhe dëshmi e viteve të shërbimit në strukturat e Forcave të Armatosura.

Një sfidë e re, njerëzit në qendër të misionit

Marrja e drejtimit të Qendrës së Personel Rekrutimit e vendos Kolonel Jaupin përballë një prej sfidave më të rëndësishme të Forcave të Armatosura: identifikimin dhe përzgjedhjen e brezit të ri të ushtarakëve.

Në një kohë kur modernizimi i Forcave të Armatosura kërkon jo vetëm kapacitete të reja teknologjike, por mbi të gjitha burime njerëzore të afta, të motivuara dhe profesionalisht të përgatitura, puna e kësaj Qendre merr një rëndësi të veçantë. Nga procesi i rekrutimit nis edhe një pjesë e rëndësishme e rrugëtimin të çdo ushtaraku. Është vendi ku një i ri shpreh dëshirën për të veshur uniformën, ku vlerësohen aftësitë dhe potenciali i tij dhe ku nis rruga drejt një profesioni që kërkon disiplinë, përgjegjësi dhe përkushtim ndaj vendit. Me përvojën e tij në menaxhimin e personelit dhe drejtimin ushtarak, Kolonel Vladimir Jaupi nis këtë detyrë të re me një profil të ndërtuar në vite dhe me një përgjegjësi të qartë: **të kontribuojë në përzgjedhjen e njerëzve që do të përbëjnë Forcat e Armatosura të së ardhmes.**

Një detyrë e re, një përgjegjësi e re dhe një tjetër kontribut në shërbim të uniformës shqiptare.

Gazeta “Ushtria” i uron Kolonel Vladimir Jaupit sukses në detyrën e re dhe përmbushje të misionit në drejtimin e Qendrës së Personel Rekrutimit.

KONTINGJENTI XX EOD NIS MISIONIN 6-MUJOR NË LETONI

Komanda Mbështetëse përcjell efektivët shqiptarë drejt misionit ndërkombëtar

Efektivët të Komandës Mbështetëse dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nisën sot misionin e tyre 6-mujor në Letoni, në kuadër të angazhimit të Shqipërisë në strukturat shumëkombëshe të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Kontingjenti XX EOD do të jetë pjesë përbërëse e **Brigadës Shumëkombëshe Letoneze**, duke u angazhuar në kuadër të misionit ndërkombëtar të **Forcës së Përparuar Tokësore**. Përgjatë periudhës së misionit, efektivët shqiptarë do të kontribuojnë me profesionalizëm, disiplinë dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave të përcaktuara, duke përfaqësuar denjësisht Forcat e Armatosura të Shqipërisë.

Në ceremoninë e përcjelljes së kontingjentit mori pjesë edhe zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Razie Mehmeti, e cila uroi efektivët për një mision të suksesshëm dhe i falënderoi për gatishmërinë, përkushtimin dhe sakrificën që tregojnë në shërbim të vendit dhe detyrimeve ndërkombëtare.

Në fjalën e saj, gjeneral brigade Mehmeti vlerësoi rëndësinë e kontributit të çdo efektivi në misionet ndërkombëtare, duke theksuar se përfaqësimi i Forcave të Armatosura përtej kufijve të vendit është një përgjegjësi e lartë dhe një dëshmi e profesionalizmit të ushtarakëve shqiptarë.

Kontingjenti XX EOD niset drejt Letonisë me përgjegjësinë për të përmbushur me sukses misionin, për të bashkëpunuar ngushtë me trupat aleate dhe partnere dhe për të ngritur edhe një herë lart emrin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në angazhimet e përbashkëta të sigurisë dhe mbrojtjes.

Mision të suksesshëm dhe kthim të sigurt!



KURRË NUK ËSHTË VETËM NJË TEST, ËSHTË HAPI I PARË DREJT UNIFORMËS SË OFICERIT

Në Qendrën e Personel Rekrutimit, kandidatët për Kursin e Përgatitjes së Oficerit përballen me sfidën e përgatitjes fizike, intelektuale dhe psikologjike

Në një sallë testimi, në një pistë sportive apo përballë një testi psikologjik, ajo që duket si një procedurë përzgjedhjeje është në të vërtetë shumë më tepër. Për kandidatët që synojnë të bëhen oficerë të Forcave të Armatosura, çdo etapë është një provë e vullnetit, disiplinës dhe përgatitjes për një profesion që kërkon përgjegjësi të veçantë.

Në **Qendrën e Personel Rekrutimit**, vijon procesi i testimit të kandidatëve për **Kursin e Përgatitjes së Oficerit (KPO)**. Kandidatët përballen me disa etapa vlerësimi, ku testimi fizik ndërthuret me atë intelektual dhe psikologjik, ndërsa një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe njohurive në gjuhë të huaja.

Pas çdo testi qëndron një synim i qartë: **të përzgjidhen kandidatët më të përshtatshëm për të marrë përsipër përgjegjësinë e uniformës së oficerit.**

Kjo është arsyeja pse procesi nuk mat vetëm forcën fizike apo njohuritë teorike. Ai kërkon të evidentojë edhe aftësinë për të menduar, për të përballuar situata të ndryshme, për të bashkëpunuar dhe për të marrë përgjegjësi.

Për disa prej kandidatëve kjo mund të jetë dita e parë e një karriere të gjatë ushtarake. Për të tjerë, një ëndërr që ka nisur shumë më herët dhe tashmë po përballet me provën e parë konkrete.

Në fund të procesit, ata që do të përzgjidhen nuk do të fitojnë vetëm një vend në një kurs. Ata do të hedhin **hapin e parë drejt një prej përgjegjësisve më të mëdha që mund të mbajë një ushtarak, të bëhet oficer i Forcave të Armatosura.**

Rruga nuk është e lehtë. Por çdo karrierë e madhe nis me një hap.

Dhe për këta të rinj, ky hap sot matet me **disiplinë, përgatitje, vullnet dhe besim te vetja.**



Ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, vizitoi Bazën e Mbështetjes së Emergjencave Civile në 39-vjetorin e krijimit të saj. Gjatë periudhës prill-gusht 2026, BMEC ka realizuar 54 operacione për shuarjen e zjarreve, duke angazhuar mbi 1 500 efektivë dhe më shumë se 180 mjete.

Në ditët kur flakët përfshijnë pyje, kodra e zona të banuara, kur terreni bëhet i vështirë dhe rreziku për jetën rritet, Forcat e Armatosura janë aty. Në vijën e parë, përballë një prej emergjencave më të vështira të sezonit veror, efektivët nuk përballen vetëm me zjarrin, por edhe me temperaturat e larta, terrenin e thyer dhe lodhjen e gjatë fizike.

Në këtë betejë të përditshme, **Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC)** vijon të mbajë një rol të rëndësishëm në organizimin dhe mbështetjen e operacioneve në të gjithë territorin e vendit.

Në 39-vjetorin e krijimit të kësaj strukture, e cila është pjesë e Komandës Mbështetëse të Ministrisë së Mbrojtjes, ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, zhvilloi një vizitë në BMEC, ku vlerësoi nga afër angazhimin dhe kontributin e efektivëve gjatë sezonit të zjarreve.

54 operacione në pesë muaj

Shifrat e këtij sezoni dëshmojnë përmasat e angazhimit. Gjatë periudhës prill-gusht 2026, BMEC ka zhvilluar 54 operacione për shuarjen e zjarreve, ku janë angazhuar mbi 1 500 efektivë të Forcave të Armatosura dhe janë përdorur mbi 180 mjete.

Pas këtyre shifrave qëndrojnë qindra orë pune në terren, lëvizje në zona të vështira, operacione të zgjatura dhe përballje të drejtpërdrejtë me rrezikun.

Efektivët e Forcave të Armatosura janë angazhuar në mbështetje të autoriteteve civile, duke kontribuar në izolimin dhe shuarjen e vatrave të zjarrit, mbrojtjen e zonave të rrezikuara dhe përballimin e situatave emergjente.

“Shtylla kurrizore” e emergjencave civile

Gjatë vizitës në BMEC, ministri Nufi vlerësoi rolin që kjo strukturë ka në sistemin kombëtar të përballimit të emergjencave.

“Kjo strukturë vazhdon të ngelet struktura operacionale, e cila është shtylla kurrizore e të gjithë veprimtarisë së mbështetjes në rastin e emergjencave civile, apo fatkeqësive natyrore në territorin e Republikës së Shqipërisë”, - u shpreh ministri Nufi.

Kjo qasje e vendos BMEC-në në një rol të rëndësishëm operacional, jo vetëm në përballimin e zjarreve, por edhe në mbështetjen e strukturave civile gjatë situatave të ndryshme të emergjencës.

Kapacitetet njerëzore, mjetet dhe organizimi operacional përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm për reagimin e shpejtë dhe të koordinuar kur një situatë emergjente kërkon ndërhyrjen e Forcave të Armatosura.

Mirënjohje për ata që u përballën me flakët

Në fokus të fjalës së ministrit ishte edhe puna e efektivëve që kanë qenë në terren gjatë këtij sezoni. Përballë zjarreve, ata kanë qenë ndër të parët që janë përballur me situatat më të rrezikshme, duke vënë në dispozicion profesionalizmin, përgatitjen dhe gatishmërinë e tyre.

“Jam krenar për përkushtimin e tyre, mirënjohës gjithsecilit prej tyre që ka qenë në vijën e parë të luftës kundër zjarreve në këtë sezon veror kaq të vështirë”, - deklaroi Nufi.

Mirënjohja për efektivët shkon përtej një vlerësimi institucional. Ajo është edhe një vlerësim për njerëzit që, në kushtet e temperaturave ekstreme dhe terreneve të vështira, kanë zgjedhur të jenë në vendin ku nevojitet më shumë ndërhyrja.

BMEC, një strukturë e gatshme për emergjencat

E krijuar 39 vite më parë, Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile ka vijuar të përshtatet me nevojat e reja operacionale dhe me sfidat që sjellin emergjencat natyrore.

Sot, BMEC përfaqëson një kapacitet të rëndësishëm të Forcave të Armatosura për mbështetjen e strukturave civile dhe për reagimin në situata të jashtëzakonshme.

Angazhimi gjatë këtij sezoni të zjarreve është një tjetër dëshmi e rolit të saj në terren: 54 operacione, mbi 1 500 efektivë dhe mbi 180 mjete të angazhuara në një periudhë pesë mujore. Në një kohë kur ndryshimet klimatike dhe temperaturat ekstreme po i bëjnë më të shpeshta dhe më të vështira emergjencat natyrore, kapacitetet e reagimit marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe.

Dhe në këtë sistem reagimi, Forcat e Armatosura mbeten një nga strukturat kryesore të gatshme për të ndërhyrë aty ku nevoja është më e madhe.

BMEC vazhdon misionin e saj: të jetë gati, të reagojë shpejt dhe të mbështesë qytetarët në momentet kur vendi përballlet me emergjenca.

39 VITE NË SHËRBIM TË EMERGJENCAVE

MBI 1 500 EFEKTIVË NË VIJËN E PARË TË ZJARREVE

BMEC, shtylla operacionale e Forcave të Armatosura në përballimin e emergjencave civile



STËRVITJE, NDËRVEPRUESHMËRI, ALEANCË

Kontingjenti VIII i Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut zhvillon stërvitje të përbashkët me trupat italiane në Novo Selo

Novo Selo, Bullgari – Stërvitja e përbashkët, bashkëpunimi dhe ndërveprueshmëria janë në themel të gatishmërisë së forcave aleate. Në këtë kuadër, **Kontingjenti VIII i trupave të Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut (RKV)**, i dislokuar në Novo Selo, Bullgari, në kuadër të misionit të NATO-s **Forward Land Forces (FLF)**, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me personelin italian.



Stërvitja përfshiu një sërë temash dhe skenarësh operacionalë, ndër të cilët qitja luftarake, mbrojtja e afërt dhe patrullimi gjatë natës, duke vënë në provë aftësitë individuale dhe kolektive të efektivëve. Përmes trajnimit të përbashkët, personeli shqiptar dhe italian konsoliduan procedurat e veprimit dhe rritën aftësinë për të operuar në mënyrë të koordinuar, në përputhje me standardet dhe kërkesat e përbashkëta të Aleancës.



Një rëndësi të veçantë pati **ndërveprueshmëria**, e cila përbën një nga elementet themelore të angazhimit të forcave aleate në misionet e NATO-s. Përvoja e përbashkët në stërvitje krijon mundësi për shkëmbimin e njohurive, harmonizimin e procedurave dhe forcimin e besimit reciprok mes trupave. Angazhimi i efektivëve shqiptarë në këtë aktivitet, së bashku me personelin italian, dëshmoi edhe një herë vlerën e partneritetit me një vend mik dhe aleat në NATO.

Stërvitja e përbashkët nuk është vetëm një provë e aftësive luftarake. Është një investim në gatishmëri, besim dhe ndërveprueshmëri, elemente që forcojnë kapacitetet e Aleancës dhe mundësojnë përmbushjen me profesionalizëm të çdo misioni.

Për Kontingjentin VIII, çdo ditë trajnimi në kuadër të FLF-së është një tjetër hap drejt një force më të aftë, më të koordinuar dhe më të gatshme për të vepruar krah për krah me aleatët.

ARBËR GJOKA: TRANSPORTI ËSHTË SHTYLLA QË I MUNDËSON FORCËS TË MOS NDALE KURRË

Komandanti i Batalionit të Transportit: Nga përvoja e viteve te modernizimi i flotës, nga misionet në Kosovë e emergjencat civile te sfidat e reja të Forcave të Armatosura



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Jo të gjitha strukturat ushtarake shihen në vijën e parë të misionit, sepse ka të tjera që punojnë në heshtje, shpesh larg vëmendjes së publikut, por pa të cilat asnjë operacion nuk mund të realizohet. **Transporti është një prej tyre.**

Një forcë mund të jetë e stërvitur, e pajisur dhe e gatshme, por për të lëvizur njerëz, mjete, pajisje dhe ngarkesa aty ku kërkohet, në kohë paqeje, krize apo lufte, nevojitet një strukturë transporti e aftë, e disiplinuar dhe gjithmonë në gatishmëri.

Në krye të Batalionit të Transportit ndodhet **Arbër Gjoka**, oficer karriere i Forcave të Armatosura, i cili e ka ndërtuar rrugëtimin e tij profesional në detyra të vazhdueshme komanduese.

Në këtë intervistë për gazetën **“Ushtria”**, komandanti i Batalionit të Transportit flet për rrugëtimin e tij, misionin e transportit, operacionet në Kosovë, menaxhimin e municioneve, emergjencat civile, bashkëpunimin me pushtetin vendor, standardet e NATO-s, modernizimin e flotës dhe mbi të gjitha për njerëzit që qëndrojnë pas çdo misioni të suksesshëm.

I nderuar komandant Gjoka, le ta nisim këtë intervistë nga rrugëtimi juaj në Forcat e Armatosura. Çfarë ju shtyu drejt profesionit ushtarak?

Rruga ime në Forcat e Armatosura ka nisur shumë vite më parë dhe ka qenë një rrugëtim i gjatë, me shumë detyra, përgjegjësi dhe sfida. Pas përfundimit të shkollës së mesme të përgjithshme “Pjetër Budi” në vitin 2001, zgjodha të vijoj studimet në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, në specialitetin Këmbësori.

Që në atë periudhë kuptova se profesioni ushtarak kërkon jo vetëm disiplinë dhe përgatitje profesionale, por mbi të gjitha përgjegjësi, sakrificë dhe gatishmëri për t’i shërbyer vendit.

Më pas kam vijuar me një sërë kursesh profesionale: Kursin e Avancuar të Oficerit në vitin 2010, Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit në vitin 2017 dhe Kursin e Komandës dhe të Shtabit të Përgjithshëm në vitin 2023.

Çdo etapë e arsimimit tim ka qenë një mundësi për të fituar njohuri të reja dhe për t’i shërbyer më mirë detyrave që më janë besuar.

Karriera juaj është zhvilluar kryesisht në detyra komanduese. Çfarë ju ka mësuar ky rrugëtim?

Komanda të mëson para së gjithash përgjegjësinë. Sa më lart të ngjitesh në strukturën komanduese, aq më e madhe bëhet përgjegjësia ndaj njerëzve dhe misionit. Kam filluar si komandant toge dhe më pas kam kryer detyra si zëvendëskomandant grupi, komandant grupi, komandant kompanie, shef seksioni dhe aktualisht komandant batalioni. Gjatë këtyre viteve kam kuptuar se suksesi i një strukture nuk është rezultat i një personi të vetëm. Ai është rezultat i punës së ekipit.

Një komandant duhet të dijë të dëgjojë, të vlerësojë kapacitetet e njerëzve që drejton dhe të krijojë besim. Në ushtri, puna individuale është e rëndësishme, por puna kolektive është ajo që e çon misionin deri në fund.

Ju keni kaluar nga strukturat e furnizimit dhe



ARBËR GJOKA, Komandanti i Batalionit të Transportit

logjistikës drejt komandimit të Batalionit të Transportit. Sa e rëndësishme është kjo përvojë për detyrën që mbani sot?

Është një përvojë shumë e rëndësishme. Logjistika dhe transporti janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Për shumë vite kam shërbyer në strukturat e furnizimit dhe kam qenë pjesë e proceseve që lidhen me mbështetjen logjistike. Kjo më ka dhënë mundësinë të kuptoj nga afër se sa e rëndësishme është që çdo hallkë e sistemit të funksionojë në kohën dhe mënyrën e duhur.

Sot, në drejtimin e Batalionit të Transportit, kjo eksperiencë më ndihmon të shoh misionin në një këndvështrim më të plotë.

Transporti nuk është thjesht lëvizja e një automjeti nga një pikë në tjetrën. Pas tij qëndron planifikimi, mirëmbajtja, personeli, siguria, gatishmëria dhe përgjegjësia për realizimin e detyrës

Ju e keni cilësuar transportin si një prej shtyllave

kryesore të logjistikës. Pse?

Rëndësia e transportit flet vetë. Mjafton të imagjinojmë një qytet pa transport për të kuptuar se sa jetik është ky sektor. Për Forcat e Armatosura, transporti nuk është thjesht një nevojë. Është një detyrë dhe një angazhim i madh.

Ne jemi pjesa që punon shpesh pas kuintave, me përkushtim dhe seriozitet, për të siguruar që forcat operacionale të mos ndalen, pavarësisht llojit të operacionit.

Misioni ynë është mbështetja me transport e Komandës Mbështetëse dhe strukturave të Forcave të Armatosura, në kohë paqeje, krize apo lufte.

Ky mision përfshin transportin e personelit dhe ngarkesave, brenda dhe jashtë vendit, në mbështetje të operacioneve.

Pra, nëse forca duhet të lëvizë, të disloketohet apo të mbështetet, transporti duhet të jetë aty.

Çfarë kapacitetesh ka aktualisht Batalioni i Transportit për përmbushjen e këtij misioni?



Batalioni disponon kapacitete me mjete të lehta, të rënda dhe mjete speciale, të cilat përdoren në varësi të natyrës së detyrës. Një element shumë i rëndësishëm është edhe eksperiencia e drejtuesve të mjeteve. Aftësia e tyre profesionale ka qenë dhe mbetet një prej faktorëve kryesorë për garantimin e gatishmërisë dhe mirëmbajtjen e flotës.

Puna e drejtuesit të mjetit në Forcat e Armatosura nuk është një punë e zakonshme. Shpesh ata përballen me distanca të gjata, terrene të vështira, kushte atmosferike të ndryshme dhe detyra që kërkojnë përqendrim maksimal. Kjo sakrificë është kthyer në një traditë të trashëguar brez pas brezi.

Një nga sfidat e rëndësishme sot është modernizimi i flotës. Ku ndodhet Batalioni në këtë proces?

Sot ndodhemi në një fazë të rëndësishme përmirësimi të flotës së mjeteve. Shumë shpejt do të kemi një flotë më moderne dhe funksionale për detyra specifike. Procesi ka nisur me marrjen e mjeteve të reja nga kompania shqiptare **TIMAK Defence**.

Ky është një zhvillim i rëndësishëm sepse modernizimi i mjeteve lidhet drejtpërdrejt me rritjen e kapaciteteve tona operacionale. Por modernizimi nuk është vetëm çështje mjeteshe. Një mjet modern kërkon personel të aftë për ta përdorur, mirëmbajtur dhe integruar në sistemin e mbështetjes.

Prandaj, paralelisht me modernizimin e flotës, duhet të vazhdojmë investimin tek njerëzit.

Sa ka ndryshuar personeli i Batalionit të Transportit në raport me standardet e NATO-s?

Ndryshimi ka qenë gradual, por i natyrshëm. Eksperiencia e viteve, puna e palodhur dhe përkushtimi kanë bërë të mundur përmbushjen e standardeve të NATO-s. Kjo është arritur edhe falë stërvitjeve të përbashkëta dhe misioneve ndërkombëtare ku personeli ynë ka marrë pjesë.

Kemi bashkëpunuar ngushtë me forcat e vendeve të Aleancës dhe kemi realizuar detyra të rëndësishme pa ndier presion, falë aftësive të trashëguara, por edhe atyre të fituara përmes kurseve profesionale dhe trajnimeve. Ne sot ndihemi të barabartë me anëtarët e tjerë të Aleancës ku bëjmë pjesë.

Ju përmendët edhe përvojën në GBKL. Çfarë ka sjellë kjo eksperiencë?

Prej shumë kohësh jemi pjesë e GBKL me një togë të dedikuar. Kjo na ka dhënë mundësinë të fitojmë eksperiencë dhe besim në vetvete për realizimin e detyrave të veçanta, përtej rutinës së përditshme. Çdo angazhim i tillë është një mundësi për të testuar aftësitë individuale dhe kolektive.

Në fund të fundit, gatishmëria nuk matet vetëm në ditët kur gjithçka shkon normalisht. Ajo matet në momentin kur vjen një detyrë e papritur dhe ti duhet të jesh gati ta përmbushësh atë.

NJERËZIT QË PUNOJNË “PAS KUINTAVE”
Shpesh publiku sheh një operacion të përfunduar, por

nuk sheh punën që qëndron pas tij. Çfarë do të donit t’u thoshit efektivëve të Batalionit të Transportit?

Detyra jonë është e rëndësishme, por aftësitë e personelit e bëjnë të duket e thjeshtë në sytë e të tjerëve. Pas kësaj “thjeshtësie” qëndrojnë trajnimi, puna, disiplina dhe sakrifica e vazhdueshme.

Unë do t’i falënderoja të gjithë efektivët për punën e tyre. Çdo drejtues mjeti, çdo specialist, çdo ushtarak që merr pjesë në një detyrë transporti është pjesë e drejtpërdrejtë e suksesit të misionit. Transporti është një zinxhir dhe nëse një hallkë nuk funksionon siç duhet, ndikohet i gjithë misioni. Prandaj, puna e secilit ka rëndësi.

SFIDA E SË ARDHMES: NJERËZIT DHE TEKNOLOGJIA
Cilat janë sfidat kryesore që shihni për të ardhmen?

Sfida është ruajtja e kapaciteteve dhe përmirësimi i tyre. Sfida është të mos e ulim ritmin e punës që brezat na kanë trashëguar. Një tjetër sfidë është aftësimi individual dhe aftësimi për të punuar në grup. Duhet të vazhdojmë të trajnojmë njerëzit tanë, sepse teknologjia ndryshon dhe bashkë me të ndryshojnë edhe kërkesat e misionit.

Por unë jam optimist. E ardhmja është në duar të sigurta dhe këtë e tregon edhe dëshira e të rinjve për t’u bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

Aftësitë e tyre në teknologji, një fushë shumë e rëndësishme për të ardhmen e ushtrisë, do t’i japin një hov të ri dhe të sigurt zhvillimit të Forcave të Armatosura.



MEDALJA, NJË MIRËNJOHJE DHE NJË PËRGJEGJËSI
Batalioni ka marrë edhe vlerësime për punën e kryer.
Çfarë përfaqëson për ju një medalje?

Medalja është një tregues i qartë i punës, sakrificës dhe angazhimit ndër vite. Por unë e shoh edhe si një udhërrëfyes për atë që duhet të bëjmë sot dhe në të ardhmen. Një vlerësim nuk duhet të jetë arsye për të ndaluar. Përkundrazi, ai duhet të të vendosë përpara një përgjegjësie të re.

Nëse një brez ka ndërtuar një standard, brezi pasardhës duhet ta ruajë dhe ta përmirësojë atë.

Ky është detyrimi ynë.
99 VJET TRANSPORT USHTARAK

Në 99-vjetorin e Shërbimit të Transportit, cili është mesazhi juaj për efektivët dhe familjet e tyre?

Kjo datë shënon fillimin e një rrugëtimi të gjatë, të vështirë dhe plot angazhime. Brezat e rinj kanë trashëguar përvojën dhe shembullin e brezave pararendës dhe kanë ndjekur një rrugë të qartë drejt suksesit.

Respekti për punën e tyre ndër vite na e ka bërë më të lehtë ecjen përpara dhe na ka dhënë obligimin që të vazhdojmë punën me profesionalizëm, dëshirë dhe përkushtim.

Dua të falënderoj të gjithë efektivët e Batalionit të Transportit për përkushtimin dhe sakrificën e tyre.

Por një falënderim i veçantë shkon edhe për të gjithë efektivët që kanë shërbyer ndër vite në këtë strukturë.
Gëzuar Ditën e Transportit!

Dhe sigurisht, një urim i veçantë shkon për familjarët e tyre. Shpesh ata nuk kanë qenë të pranishëm në ditët e gëzimit të familjes, sepse detyra i ka thirrur diku tjetër. Ata janë mbështetja jonë e padukshme. Janë ata që na japin forcën për të vazhduar dhe për të realizuar detyrat në interes të misionit.

Prandaj, në këtë 99-vjetor, mirënjohja shkon edhe për ta.

Transporti nuk është gjithmonë në qendër të fotografisë. Nuk është gjithmonë në vijën e parë të ekranit.

Shpesh është aty, në heshtje, në kilometrat e rrugëve, në netët pa gjumë, në timonin e një automjeti që duhet të mbërrijë në kohë, në mirëmbajtjen e një mjeti që duhet të jetë gati dhe në urdhrin që duhet të zbatohet pa vonesë.

Por pikërisht këtu qëndron rëndësia e tij.
Një ushtri që lëviz, operon. Një ushtri që transporton, mbështet. Një ushtri që është gjithmonë në gatishmëri, është një ushtri që nuk ndalet.

Në 99 vite histori, Shërbimi i Transportit ka kaluar nëpër ndryshime të mëdha. Nga mjetet dhe kapacitetet e dikurshme te standardet e sotme, nga përvoja e brezave te teknologjia moderne.

Dhe rrugëtimi vazhdon.
Me njerëz që kanë trashëguar sakrificën e brezave të mëparshëm. Me të rinj që sjellin njohuritë e teknologjisë. Me një flotë që po modernizohet.

Dhe me një mision që mbetet i pandryshuar: **të sigurojë që Forcat e Armatosura të kenë gjithmonë mundësinë të jenë aty ku vendi dhe misioni i kërkojnë.**

BILBIL BITRI, GJENERALI SHQIPTAR NË KRYE TË NJË BRIGADE SHUMËKOMBËSHE

Nga “Skënderbej” në strukturat euroatlantike të sigurisë, një karrierë e ndërtuar mbi komandën, profesionalizmin dhe përfaqësimin e Shqipërisë

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Karriera e ushtarakut nuk është thjesht një detyrë e përfunduar, është një jetë që merr kuptim përtej individit dhe bëhen pjesë e historisë së një institucioni, të një ushtrie dhe të një vendi.

Për **Gjeneral Brigade Bilbil Bitrin**, ceremonia e zhvilluar në Stamboll, me rastin e zhvendosjes së Shtabit të Brigadës së Evropës Juglindore (**SEEBRIG**), ndërrimit të komandës dhe shënimit të 27-vjetorit të krijimit të saj, ishte pikërisht një prej këtyre momenteve.

Pas një periudhe trevjeçare nën drejtimin e Shqipërisë, Gjeneral Brigade Bilbil Bitri dorëzoi zyrtarisht komandën e SEEBRIG, duke ia kaluar detyrën Gjeneral Brigade **Ivan Malamov** të Bullgarisë.

Por ceremonia në Stamboll nuk shënoi vetëm fundin e një mandati. Ajo ishte një pikë reflektimi mbi një rrugëtim të gjatë profesional, mbi një karrierë që nisi në vitin 1989 në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” dhe vijoi në nivelet taktike, operacionale dhe strategjike të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, deri në strukturat ndërkombëtare të sigurisë.

Është historia e një oficeri që e ka ndërtuar karrierën nga toka e njësisë, përmes shtabit dhe komandës, deri te tavolinat ku merren vendime për sigurinë rajonale dhe euroatlantike.

Nga “Skënderbej” te komandimi i SEEBRIG

Gjeneral Brigade Bilbil Bitri u diplomua në **Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë, në vitin 1989**, dhe menjëherë pas diplomimit u emërua oficer aktiv i Artilerisë së Mbrojtjes Kundërajrore.

Detyra e parë e tij ishte ajo e **komandantit të togës** në repartet e Mbrojtjes Kundërajrore në Tiranë dhe rrethinat e saj.

Ishte fillimi i një karriere që do të kalonte nëpër nivele të ndryshme të komandimit dhe përgjegjësisë.

Në vitet e para, si një toger i ri, përvoja e tij u formësua në terrenin konkret të njësisë ushtarake. Më pas, angazhimi në struktura me prioritet, si **Regjimenti Komando**, i dha mundësinë të njihte nga afër dimensione të tjera të veprimtarisë ushtarake.

Në këtë periudhë ai u angazhua veçanërisht në fushën e **Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak (CIMIC)** dhe të informimit publik.

Ishte një periudhë kur Forcat e Armatosura të Shqipërisë po rrisnin gjithnjë e më shumë pjesëmarrjen në operacionet dhe misionet ndërkombëtare.

Eksperiencia e fituar në kuadër të angazhimeve shqiptare në **ISAF në Afganistan, “Iraqi Freedom” në Irak dhe SFOR në Bosnjë-Hercegovinë**, i dha oficerit Bitrit një perspektivë të re mbi mënyrën se si një forcë kombëtare ndërvepron me struktura dhe partnerë ndërkombëtarë.

Nga niveli taktik te ai strategjik

Karriera e Gjeneral Bitrit nuk u kufizua në një dimension të vetëm të profesionit ushtarak.

Ajo kaloi gradualisht nga niveli taktik, në atë operacional dhe më pas në atë strategjik.

Në nivelin operacional, përvoja e tij përfshiu detyrën e Shefit të Degës G5 në Forcat Tokësore, si dhe funksionin e Shefit të Shtabit të Forcave Tokësore.

Në nivelin strategjik, ai ka mbajtur një sërë detyrash të rëndësishme në strukturat drejtuese të Forcave të



Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Ndër to përfshihen detyrat si:

- Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;**
- Drejtor J5;**
- Drejtor J3;**
- Shef Kabineti i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm;**
- Drejtor i Drejtorisë së NATO-s, BE-së dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes;**
- Drejtor i Informimit Publik në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.**

Këto detyra dëshmojnë një karrierë të ndërtuar në disa fusha të rëndësishme të profesionit ushtarak: komandim, planifikim operacional, marrëdhënie ndërkombëtare, politikë e mbrojtjes, komunikim strategjik dhe drejtim institucional.

Përvoja ndërkombëtare - Shqipëria në tryezat e sigurisë

Një tjetër dimension i rëndësishëm i karrierës së Gjeneral Brigade Bilbil Bitrit është përvoja e tij në strukturat ndërkombëtare.

Ai ka shërbyer si Përfaqësues i Lartë Kombëtar pranë Komandës Qendrore të Shteteve të Bashkuara – CENTCOM, në Tampa, Florida, si dhe si Zëvendës Përfaqësues Kombëtar pranë Komandës Supreme Aleate për Transformimin – ACT, në Norfolk, Virginia.

Këto detyra e kanë vendosur atë në mjedise ku çështjet e mbrojtjes, strategjisë, interoperabilitetit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare trajtohen në nivel të lartë.

Pikërisht kjo përvojë ndërkombëtare do të ishte një nga komponentët e rëndësishëm të formimit të tij për detyra të mëvonshme në strukturat shumëkombëshe.

Sepse të komandosh një strukturë si SEEBRIG kërkon jo vetëm njohuri ushtarake. Kërkon të kuptosh partneritetin. Kërkon të komunikosh përtej gjuhës së uniformës. Kërkon të ndërtohet besim ndërmjet vendeve dhe ushtrive.

Një komandant me përvojë në arsimimin ushtarak

Për Gjeneral Bitrin, profesioni ushtarak nuk është konceptuar vetëm si komandë.

Një pjesë e rëndësishme e karrierës së tij është lidhur edhe me arsimimin dhe edukimin ushtarak.



Ai ka dhënë mësim për rreth gjashtë vite në **Akademinë Ushtarake Shqiptare**, duke ligjëruar dhe zhvilluar leksione e prezantime për audienca vendase dhe ndërkombëtare mbi Forcat e Armatosura Shqiptare, studimet strategjike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në periudhën tetor 2022 – shtator 2023, ai mbajti detyrën e **Komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura**.

Ky funksion ishte një tjetër dëshmi e dimensionit të tij si ushtarak dhe edukator, në një institucion që formon brezat e ardhshëm të oficerëve shqiptarë.

Formimi akademik – strategjia si pjesë e profesionit

Formimi i Gjeneral Brigade Bilbil Bitrit është shtrirë përtej arsimit të mirëfilltë ushtarak. Pas diplomimit në Akademinë “Skënderbej”, ai përfundoi Kolegjin e Komandës dhe Shtabit në Forcat e Armatosura Shqiptare në vitin 2006, si dhe Kursin e Oficerit të Lartë në Akademinë e Forcave të Armatosura në vitin 2014. Në vitin 2017 ai u diplomua në “U.S. Army War College”, në kuadër të klasës AY 2017, ku mori gradën akademike Master në Studime Strategjike. Gjithashtu, ai zotëron Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare, të përfutur nga “Old Dominion University” dhe Universiteti Evropian i Tiranës. Ky kombinim ndërmjet formimit ushtarak, studimeve strategjike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare ka ndikuar në profilin e tij profesional si një oficer i angazhuar jo vetëm në drejtimin e forcave, por edhe në analizën dhe përfaqësimin e çështjeve të sigurisë.

SEEBRIG, një tjetër provë e profesionalizmit shqiptar

Më 26 shtator 1998, Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Maqedonia, Rumania dhe Turqia nënshkruan Marrëveshjen për Krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Paqes të Evropës Juglindore (**MPFSEE**), duke hedhur themelet e krijimit

të SEEBRIG. Qëllimi ishte krijimi i një strukture që do të mund të kontribuonte në operacionet paqeruajtëse, misionet e shpëtimit dhe ato humanitare, në kuadër të mandateve të Kombeve të Bashkuara ose OSBE-së. Në këtë kuadër, SEEBRIG është shndërruar në një instrument të rëndësishëm të bashkëpunimit rajonal. Për Shqipërinë, pjesëmarrja në këtë strukturë ka qenë një mundësi për të kontribuar drejtpërdrejt në sigurinë rajonale dhe në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore.

Në vitin 2023 Shqipëria mori komandën e SEEBRIG.

Për tre vite, në krye të Brigadës ishte Gjeneral Brigade Bilbil Bitri. Kjo periudhë ishte një tjetër kapitull i rëndësishëm në karrierën e tij dhe në përfaqësimin e Forcave të Armatosura shqiptare në strukturat shumëkombëshe.

15 korrik 2026, kur një mandat bëhet histori

Në Kumanovë, më 15 korrik 2026, SEEBRIG mbylli kapitullin gjashtëvjeçar të pranisë së Shtabit në Kampin “Boro Menkov”.

Ceremonia shënoi fundin e një periudhe, por njëkohësisht edhe fillimin e një etape të re. Pak më vonë, në Stamboll, u zhvillua ceremonia zyrtare e zhvendosjes së Shtabit, ndërrimit të komandës dhe shënimit të 27-vjetorit të krijimit të Brigadës. Pas tre viteve të drejtimit shqiptar, Gjeneral Brigade Bilbil Bitri dorëzoi komandën. Gjeneral Brigade Ivan Malamov, nga Bullgaria, mori detyrën e Komandantit të ri të SEEBRIG.

Në ceremoni morën pjesë edhe zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Pranvera Skana, dhe zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigade

Razije Mehmeti. Ishte një moment për të parë pas, por edhe për të parë përpara.

Një kapitull mbyllet. Përvoja mbetet.

Në ceremoninë e Kumanovës, Gjeneral Brigade Bitri theksoi rëndësinë e mbështetjes së vendit pritës dhe vlerën e asaj që ishte ndërtuar gjatë gjashtë viteve.

Mesazhi i tij ishte një mesazh që përmbledh edhe filozofinë e bashkëpunimit shumëkombësh:

Besimi, solidariteti dhe partneriteti janë themelet e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme.

Kjo është edhe një nga arsyet pse përvoja e një komandanti si Bilbil Bitri merr rëndësi përtej mandatit të tij.

Sepse një komandë përfundon.

Një ceremoni mbyllet.

Një flamur ulet.

Por përvoja e fituar, marrëdhëniet e krijuara dhe kontributi i dhënë mbeten pjesë e trashëgimisë së institucionit.

Një karrierë në shërbim të uniformës

Rrugëtimi profesional i Gjeneral Brigade Bilbil Bitrit përfshin nivele të ndryshme të jetës ushtarake.

Ai ka qenë komandant njësie, drejtues shtabi, pedagog, drejtues i institucioneve të rëndësishme të mbrojtjes, përfaqësues i Shqipërisë në strukturat ndërkombëtare dhe, për tre vite, komandant i një brigade shumëkombëshe.

Kjo karrierë tregon edhe transformimin e vetë Forcave të Armatosura Shqiptare gjatë dekadave të fundit.

Një ushtri që ka kaluar nga modeli tradicional i mbrojtjes te një forcë që kontribuon në operacione ndërkombëtare, në struktura shumëkombëshe dhe në arkitekturën euroatlantike të sigurisë.

Në këtë rrugëtim, oficerë si Gjeneral Brigade Bilbil Bitri kanë qenë pjesë e këtij transformimi.

Gazeta **“Ushtria”** nuk është vetëm kronikë e aktiviteteve të Forcave të Armatosura.

Ajo është kujtesa e njerëzve që kanë veshur uniformën. Është hapësira ku një karrierë ushtarake mund të shihet jo vetëm përmes gradave dhe funksioneve, por edhe përmes përvojës, sakrificës, dijes dhe përgjegjësisë.

Prandaj, portreti i **Gjeneral Brigade Bilbil Bitrit** është më shumë se një profil personal.

Është portreti i një brezi ushtarakësh shqiptarë që kanë kaluar nga bankat e Akademisë “Skënderbej” te strukturat moderne të sigurisë ndërkombëtare.

Nga togëkomandanti te gjenerali. Nga njësia në terren te shtabet strategjike.

Nga Shqipëria në Tampa, Norfolk, Kumanovë e Stamboll. Një rrugëtim ku uniforma shqiptare ka qenë gjithmonë pjesë e identitetit dhe përgjegjësisë.

Sepse historia e Forcave të Armatosura nuk shkruhet vetëm me data. Ajo shkruhet me njerëz.

Dhe njerëzit në uniformë meritojnë që historia e tyre të tregohet.

“Ushtria” do të jetë gjithmonë tribuna e tyre.



TË LEXOSH BOTËN PËRMES GJEOPOLITIKËS, GJEOSTRATEGJISË DHE TEKNOLOGJISË USHTARAKE

Në një kohë kur bota e sigurisë po ndryshon më shpejt se kurrë, të kuptosh luftën nuk mjafton më vetëm të numërosh tanket, avionët apo raketat. Sot, fuqia ushtarake matet edhe me aftësinë për të lexuar kohën, për të parashikuar lëvizjet e kundërshtarit dhe për të kuptuar se si teknologjia, gjeopolitika dhe gjeostrategjia po ndërthuren në një realitet të ri të sigurisë ndërkombëtare.

Në këtë hapësirë analitike, **koloneli në rezervë Hysni Gjergji**, sjell në faqet e gazetës “Ushtria” materiale që përpiqen të shkojnë përtej lajmit të ditës. Me përvojën e tij ushtarake dhe me vëmendjen e veçantë ndaj zhvillimeve të industrisë së mbrojtjes, teknologjisë ushtarake dhe arkitekturës së re të sigurisë, ai i sheh zhvillimet e sotme jo si ngjarje të shkëputura, por si pjesë të një transformimi më të gjerë gjeopolitik e gjeostrategjik.

Shkrimet e **koloneli Gjergjit** kanë një veçori të rëndësishme: **përpiqen të shpjegojnë atë që fshihet pas zhvillimeve ushtarake të ditës**. Çfarë do të thotë për luftën moderne intelijenca artificiale? Si ndryshon raporti i forcave kur sensorët, satelitët, dronët, sistemet e komandim-kontrollit dhe armët lidhen në një rrjet të vetëm? Çfarë forme po merr fusha

e betejës së të ardhmes? Dhe, mbi të gjitha, si po ndryshon koncepti i epërsisë ushtarake në një botë ku informacioni mund të jetë po aq vendimtar sa vetë arma?

Materiali i tij mbi **“Kill Web”** është një shembull i kësaj qasjeje. Përmes këtij koncepti, koloneli Gjergji na çon drejt një prej ndryshimeve më të rëndësishme të luftës moderne, kalimin nga një arkitekturë lineare e **“Kill Chain”** drejt një sistemi të ndërlidhur, ku sensorët, platformat, qendrat e komandimit, intelijenca artificiale dhe efektorët mund të funksionojnë si pjesë të një organizmi të vetëm operacional. Në një periudhë kur **kufijtë mes luftës tradicionale, teknologjisë, informacionit dhe gjeopolitikës po bëhen gjithnjë e më të padukshëm**, analiza të tilla marrin një rëndësi të veçantë edhe për lexuesin shqiptar. Ato ndihmojnë për të kuptuar jo vetëm se çfarë po ndodh në botë, por edhe se **ku po shkon lufta, mbrojtja kolektive dhe NATO-ja e së ardhmes**.

Për gazetën **“Ushtria”**, kontributi i koloneli në rezervë Hysni Gjergjit është një vlerë e veçantë: **një zë profesional që e sheh të tashmen me përvojën e së shkuarës ushtarake, por e lexon të ardhmen përmes teknologjisë, gjeopolitikës dhe gjeostrategjisë**.

“KILL WEB” Produkti më i ri shkencor i industrisë ushtarake të NATO-s



KOLONEL (R) HYSNI GJERGJI

“Kill Web” quhet shpikja e cila e kthen NATO-n në një armë të vetme. Po kalohet nga laboratorit shkencor dhe industria e mbrojtjes te “rrjeta vrasëse” në kufirin lindor të Aleancës. NATO nuk po ndërton thjesht më shumë armë. Po ndërton një mënyrë të re për t'i bërë të gjitha armët, sensorët, kompjuterët dhe njerëzit e saj të luftojnë si një organizëm i vetëm. Emri që përmbledh më mirë këtë revolucion është, *Kill web*. Në historinë ushtarake, epërsia ka kaluar vazhdimisht nga një teknologji te tjetra. Baruti ndryshoi luftën mesjetare. Motori me djegie të brendshme krijoi ushtrinë e mekanizuar. Radari revolucionarizoi luftën ajrore. Raketa precize e bëri distancën një element vendimtar të fuqisë luftarake. Kompjuteri dhe sateliti ndryshuan komandim-kontrollin.

Në shekullin XX pyetja për fuqinë ushtarake ishte: “Sa tanke, avionë ose raketa kemi?” Në fushëbetë të dëgjimit pyetja bëhet: “Sa shpejt mund ta shndërrojmë një sinjal në vendim dhe një vendim në efekt? Kjo diferencë mund të matet në minuta, sekonda dhe në të ardhmen, potencialisht në fraksione gjithnjë e më të vogla të ciklit të vendimmarrjes. Në dekadat e para të shekullit XXI po shfaqet një transformim tjetër, më pak i dukshëm se një tank apo një avion luftarak, por potencialisht edhe më i rëndësishëm: bashkimi i sensorëve, inteligjencës artificiale, rrjeteve të komunikimit, komandim-kontrollit dhe efektorëve **në një arkitekturë të vetme luftarake**. **Kjo arkitekturë njihet gjerësisht me termin Kill Web**. Në thelb, *Kill Web* synon që çdo sensor i autorizuar të mund të kontribuojë në zbulimin dhe identifikimin e një kërcënimi dhe çdo efektor i përshtatshëm të mund të përdorë informacionin e prodhuar nga rrjeti. Nuk kemi më domosdoshmërisht një lidhje fikse



Në historinë ushtarake, epërsia ka kaluar vazhdimisht nga një teknologji te tjetra. Baruti ndryshoi luftën mesjetare. Motori me djegie të brendshme krijoi ushtrinë e mekanizuar. Radari revolucionarizoi luftën ajrore. Raketa precize e bëri distancën një element vendimtar të fuqisë luftarake. Kompjuteri dhe sateliti ndryshuan komandim-kontrollin.

“sensori im - arma ime”, por një rrjet sensorësh, platformash, qendrash komanduese dhe efektorësh, ku të dhënat lëvizin me shpejtësi shumë më të madhe sesa në arkitekturën tradicionale. Në këtë kuptim, Kill Web nuk është vetëm teknologji. **Është një shpikje** sistemike. Dhe pikërisht këtu NATO po kërkon të ndërtojë një nga avantazhet e saj më të rëndësishme ushtarake për dekadat e ardhshme.

Për dekada, procesi i angazhimit të një objekтиви është konceptuar si një zinxhir. Një sensor zbulon objektivin. Informacioni i transmetohet një qendre komanduese. Objektivi identifikohet dhe klasifikohet. Merret vendimi. Një sistem armësh caktohet për angazhimin e tij. Në fund vlerësohet rezultati. Ky është koncepti klasik i Kill Chain. Problemi themelor është vetë fjala *chain* — zinxhir. Një zinxhir është aq i fortë sa hallka e tij më e dobët. Nëse kundërshtari neutralizon sensorin, bllokon komunikimin, godet qendrën komanduese ose ndërpret lidhjen me efektorin, procesi mund të vonohet ose të dështojë. Kill Web e ndryshon këtë logjikë. Në vend të një rruge lineare krijohen shumë rrugë alternative. Një UAV mund të zbulojë objektivin. Një radar tjetër mund të konfirmojë gjurmën. Një sistem tjetër mund ta klasifikojë. Një algoritëm mund të ndihmojë në fusion-in e të dhënave. Një qendër komanduese mund të zgjedhë efektorin **më të përshtatshëm**.

Nëse një nyje humbet, rrjeti kërkon një tjetër. Kështu, fuqia nuk qëndron vetëm te cilësia e armës, por te densiteti dhe elasticiteti i rrjetit që e rrethon atë. NATO e ka vendosur pikërisht këtë logjikë ekonomike në qendër të transformimit të saj dixhital. *Alliance Digital Strategy* e vitit 2026 përcakton si objektiv epërsinë në informacion dhe vendimmarrje për operacione shumë domenesh, të mbështetura nga kapacitete dixhitale **të sigurta**, rezistente dhe ndërvepruese dhe nga bashkëpunimi njeri–makinë. Kjo është infrastruktura konceptuale mbi të cilën ndërtohet *Kill Web*, i cili përshkruhet si një koncept transformues luftimi që integron sisteme pa ekuipazh ose me ekuipazh minimal, rrjete të integruara dhe të dhëna live, për të përshpejtuar vendimmarrjen dhe për të kompensuar avantazhet e kundërshtarit në sasi dhe befasi. Është një ide e rëndësishme pasi sipas logjikës ekonomike, NATO nuk kërkon domosdoshmërisht **që çdo objektiv të neutralizohet nga platforma më e shtrenjtë**.

Stërvitja “Sword 26” e zhvilluar në disa vende të krahut lindor të NATO-s, ka përdorur gjithashtu operacionalizimin e vlerësimit e planeve rajonale të mbrojtjes. Pra, ai që dikur mund të konsiderohej koncept futurist po kalon gradualisht në eksperimentim operacional. Krahu lindor i NATO-s po bëhet njëkohësisht vijë mbrojtjeje dhe laborator teknologjik.

Mënyra më e thjeshtë për ta kuptuar *Kill Web* është ta krahasojmë me një organizëm njerëzor. Sensorët radarët, UAV-të, sensorët elektro-optikë dhe infra të kuq, sistemet e luftës elektronike, burimet hapësinore dhe sistemet ISR që marrin informacion mbi mjedisin operacional, janë “sytë dhe veshët”. Një ushtri moderne si NATO posedon mijëra sensorë, por problemi nuk është vetëm të mbledhësh informacion. Problemi është ta kthesh inteligjencën e mbledhur në njohuri të përdorshme për vendimmarrje në kohë të shpejtë. Këtu fillon hapi i dytë, të dhënat.

Në analogjinë biologjike të trupit të njeriut, ky është “truri dhe sistemi nervor”. Këtu hyjnë algoritmet, automatizimi, shkëmbimi i informacionit dhe intelijenca artificiale. AI mund të ndihmojë në analizimin e volumeve të mëdha të informacionit, evidentimin e anomalive dhe paraqitjen më të shpejtë të kurseve të veprimit për vendimmarrësin. Në finale aktivizohen “gjymtyrët” (armët). Armë në sistemin *Kill Web* nuk duhet kuptuar vetëm një top, dron apo raketë. Ajo mund të jetë sistem i mbrojtjes ajrore, sistem i luftës elektronike, UAV, apo një kapacitet tjetër që prodhon efektin operacional **të kërkuar**.

AI-ja është pjesë e sistemit dhe përshpejtuesi i *Kill Web*, por jo komandanti i tij. Do të ishte e gabuar të barazonim

Kill Web me një sistem autonom që e vendos vetë kë dhe kur duhet të godasë. Qasja e NATO-s ndaj AI-së është shumë e kontrolluar. Intelijenca artificiale mund të përpunojë informacion më shpejt sesa njeriu. Mund të krahasojë mijëra të dhëna njëkohësisht. Mund të evidentojë objekte dhe modele që operatori njerëzor mund të mos i dallojë menjëherë. Por shpejtësia e algoritmit duhet të bashkëjetojë me njeriun, përgjegjshmërinë dhe ligjshmërinë që ai mbart. Avantazhi teknologjik i Aleancës nuk synon vetëm automatizimin maksimal, por automatizimin e kontrolluar. Në këtë model, AI-ja është përshpejtues i ciklit të vendimmarrjes, ndërsa përgjegjësia njerëzore mbetet element themelor i sistemit.

Shpikja e vërtetë në këtë rast nuk është arma, por arkitektura e *Kill Web*. NATO nuk ka “shpikur” radarin. Nuk ka shpikur dronin. Nuk ka shpikur inteligjencën artificiale. Nuk ka shpikur satelitin, artilerinë apo komunikimin dixhital. Shpikja që po merr formë është mënyra se si të gjitha këto teknologji mund të bashkohen në një arkitekturë luftarake të Aleancës. Ky dallim është thelbësor pasi epërsia teknologjike moderne nuk lind gjithmonë nga krijimi i një arme krejtësisht të re. Shpesh supremacia lind nga mënyra inteligjente e kombinimit të teknologjive ekzistuese. Një UAV është një platformë, ndërsa një radar është një sensor. Një raketë është një armë ndërsa një algoritëm është software, ndërsa një rrjet komunikimi është infrastrukturë. Por kur të gjitha këto bashkohen në një sistem që mund të zbulojë, kuptojë, vendosë dhe reagojë me shpejtësi, rezultati është shumë më i madh se shumatorja e pjesëve përbërëse. Kjo është fuqia e *Kill Web*.

Kill Web duhet parë edhe nga një këndvështrim tjetër, pasi ai është ndoshta një nga shembujt e qartë të shkrirjes së shkencës, industrisë dhe forcave të armatosura. Lufta moderne po e zvogëlon distancën ndërmjet laboratorit të industrisë ushtarake dhe frontit. Teknologjia që sot testohet nga një startup, universitet apo kompani e industrisë së mbrojtjes mund të eksperimentojë nesër me një njësi ushtarake dhe nëse funksionon, hyn më shpejt në përdorim operacional. NATO po kërkon ta institucionalizojë pikërisht këtë proces. Në “NATO Innovation Scale-Up Package”, të miratuar në korrik 2026, aleatët konfirmojnë synimin për të përshpejtuar identifikimin, testimin dhe adoptimin e produkteve të reja teknologjike. Dokumenti ndërton mbi *Rapid Adoption Action Plan*, përmes të cilit aleatët synojnë në përgjithësi që teknologjitë e reja të gjenden, testohen dhe adoptohen brenda një horizonti shumë më të shpejtë, me objektiv të përgjithshëm deri në 24 muaj.

Kill Web po ndryshon edhe kuptimin tradicional të industrisë së mbrojtjes. Industria ushtarake nuk është më vetëm uzina që prodhon municion, automjete të blinduara ose raketa. Industria e luftës së shekullit XXI përfshin kompaninë që prodhon sensorë, kompaninë që zhvillon software **për shpërndarje** të të dhënave, prodhuesin e dronëve, laboratorin e AI-së, kompaninë e cyber-security, prodhuesin e **çipave**, operatorin hapësinor dhe integruesin e sistemeve. Në *Kill Web*, edhe kodi kompjuterik mund të jetë po aq strategjik sa “çeliku” dhe të dhënat mund të jenë po aq të rëndësishme sa “municioni”.

Kill Web nuk ofron vetëm shpejtësi reagimi, por edhe logjikë ekonomike në përdorimin e fuqisë luftarake. Rrjeti duhet të ndihmojë në zgjedhjen e reaguesit edhe në mënyrë proporcionale me koston. Një lloj kërcënimi mund të neutralizohet me luftë elektronike, një tjetër me C-UAS dhe një tjetër mund të kërkojë mbrojtje kundërajrore tradicionale.

Për më shumë se një shekull ushtritë kanë konkurruar kryesisht në terma platformash. Tanku më i mire, avioni më i mire, anija më e mire, rakete me rreze më të madhe etj. Këto elemente vazhdojnë të jenë të rëndësishme, por *Kill Web* sjell një ndryshim paradigme që do të thotë platforma nuk duhet vlerësuar vetëm nga ajo që mund të bëjë e vetme, por edhe nga ajo që mund t’i japë dhe të marrë nga rrjetin në të cilin është e integruar. Një sistem që nuk e ka zbuluar vetë objektivin mund të marrë informacion për vendndodhjen e tij nga një burim tjetër. Kjo është arsyeja pse interoperabiliteti **në Kill**

Web bëhet armë, data-link bëhet armë, software bëhet armë, Cloud-i ushtarak bëhet infrastrukturë luftarake dhe cyber-security **bëhet pjesë e fuqisë së zjarrit**. Kjo është logjika e *Multi-Domain Operations*: kapacitetet tokësore, ajrore, detare, hapësinore dhe kibernetike nuk planifikohen të veçuara, por si pjesë të një sistemi të integruar. *Allied Command Transformation* e përshkruan transformimin dixhital **për MDO si krijimin e një mjedisi shumë të integruar, të automatizuar dhe** që lejon vendimmarrjeje më të shpejta dhe sinkronizim të efekteve ndërmjet domain-ve.

Çdo revolucion teknologjik nga ana tjetër krijon edhe dobësi të reja, pasi sa më shumë varet ushtria nga rrjeti *kill web*, aq më strategjike bëhet mbrojtja e këtij rrjeti. Kundërshtari nuk ka nevojë të shkatërrojë fizikisht çdo armë, por të kërkojë të sulmojë komunikimet, të korruptojë të dhënat, të bllokojë sensorët, të ndërhyjë në spektrin elektromagnetik, të sulmojë sistemet kibernetike ose të manipulojë algoritmet. Prandaj *Kill Web* duhet të jetë jo vetëm i shpejtë, por rezistent dhe i decentralizuar. NATO e lidh transformimin e saj dixhital pikërisht me sigurinë, interoperabilitetin dhe qëndrueshmërinë e rrjeteve. Strategjia e të dhënave synon gjithashtu që Aleatët të ruajnë kontrollin mbi të dhënat e tyre edhe kur ato përdoren në ekosistemin e përbashkët. Kjo është një garë e vazhdueshme e të kundërtave, armë-kundërmë. Në këtë kuptim, *Kill Web* nuk është destinacion **përfundimtar por një proces permanent evolucionar**.

Për një shtet të vogël si Shqipëria, **anëtarë të NATO-s, revolucioni** *Kill Web* sjell një përfundim strategjik të rëndësishëm. Nuk është e nevojshme që ne të prodhojmë çdo platformë të madhe për të pasur vlerë të madhe brenda Aleancës. Në një rrjet edhe një “nyje” relativisht e vogël mund të jetë strategjike nëse ofron një aftësi të rëndësishme. Për Shqipërinë, kjo do të thotë se zhvillimi i industrisë së mbrojtjes nuk duhet parë vetëm përmes prodhimit klasik të municioneve, armëve apo automjeteve ushtarake. Aleanca po kërkon më shumë pjesëmarrje industriale, arkitektura modulare dhe të hapura, interoperabilitet dhe përfshirje më të shpejtë të kompanive inovative **në ciklin e zhvillimit të kapaciteteve**. **Në epokën e** *Kill Web*, një vend i vogël si Shqipëria mund të mos ndërtojë avionin luftarak, por mund të ndërtojë një sensor **që ushqen avionin me informacion. Mund të mos prodhojë sistemin** raketor, por mund të zhvillojë software **që e lidh atë me rrjetin. Mund të mos ketë satelitë të mëdhenj por mund të ketë qendra përpunimi dhe analize. Mund të mos prodhojë të gjithë** dronin por mund të prodhojë komponentin, moduln elektronik, sistemin e komandimit ose algoritmin që e bën dronin pjesë të ekosistemit të Aleancës. Pikërisht këtu qëndron mundësia që transformimi teknologjik u jep aleatëve më të vegjël. Në një *Kill web*, rëndësi ka edhe cilësia e **nyjës** që një shtet sjell në rrjet.

Në fund, *Kill Web* **përfaqëson diçka edhe më të madhe sesa një evolucion teknologjik. Ai mund të jetë manifestimi teknologjik i vetë idesë së NATO-s**. Aleanca ka qenë gjithmonë një bashkim shtetesh. *Kill Web kërkon ta bëjë këtë gjithnjë e më shumë edhe një bashkim* sensorësh, të dhënash, algoritmesh, komandash dhe efektorësh. Kështu një radar është në një shtet, një UAV në një tjetër, një vendkomandë është shumëkombëshe, një kapacitet hapësinor merret nga një aleat tjetër; ndërsa arma, raketa droni aktivizohen nga një tjetër forcë. Të gjithë kontribuojmë në të njëjtën pamje operacionale dhe në të njëjtin cikël vendimmarrjeje. Kjo është ideja që e bën *Kill Web* shumë më tepër se një sistem armësh. *Kill web* është përpjekja për ta kthyer fuqinë kolektive të NATO-s në një organizëm luftarak të ndërlidhur dhe simbolikisht në një armë të vetme.

Në shekullin XX, simboli i fuqisë ushtarake ishte platforma: tanku, aeroplanmbajtësja, bombarduesi, raketa. Në shekullin XXI, simboli do të jetë rrjeti që i lidh të gjitha dhe pikërisht këtu qëndron “shpikja” më e rëndësishme ushtarake e epokës dixhitale **të Aleancës sonë**: krijimi i një sistemi ku e gjithë Aleanca mund të shohë, të kuptojë dhe të godasë si një e vetme. *Kill Web* nuk është thjesht arma e së ardhmes por është rrjeti që i shndërron të gjitha armët në një sistem të vetëm.



KOLONEL (R) DILAVER HOXHA

Këshilltar Politik (POLAD), SEEBRIG – Stamboll, Turqi

Gazeta “Ushtria” është tribuna ku fjala e njerëzve në uniformë merr zë, kujtesë dhe vlerë. Në faqet e saj, përvoja e ushtarakëve nuk mbetet thjesht pjesë e një karriere, por bëhet dëshmi e një kohe, e një misioni dhe e një kulture shërbimi ndaj vendit.

Në këtë hapësirë të fjalës dhe kujtesës ushtarake, **Kolonel (R) Dilaver Hoxha**, me përvojën e tij në Forcat e Armatosura dhe në strukturat shumëkombëshe të sigurisë, sjell perspektivën e një profesionisti që e njuh nga afër dimensionin ushtarak, politik dhe ndërkombëtar të mbrojtjes.

Si **Këshilltar Politik (POLAD) pranë SEEBRIG, në Stamboll**, ai përfaqëson atë brez ushtarakësh shqiptarë që e kanë shtrirë përvojën e tyre përtej kufijve kombëtarë, duke kontribuar në bashkëpunimin rajonal, dialogun dhe sigurinë e përbashkët.

Gazeta “Ushtria” i hap faqet e saj këtij zëri, sepse historia e Forcave të Armatosura nuk shkruhet vetëm nga institucionet dhe dokumentet, por edhe nga njerëzit që kanë veshur uniformën, kanë shërbyer dhe kanë mbajtur mbi supe përgjegjësinë e një misioni.

Kolonel Fahri Hima, inxhinier dhe drejtues i transportit ushtarak

Ka njerëz që gjatë jetës së tyre kryejnë detyra. Ka të tjerë që, përmes mënyrës se si i kryejnë ato, lënë pas një emër. Fahri Hima ishte nga këta të fundit.

Për ata që e njohën përmes detyrës, ai ishte oficeri, inxhinieri dhe specialisti me përvojë të gjatë. Për Forcat e Armatosura ishte një profesionist dhe drejtues i spikatur në një prej fushave më të rëndësishme të mbështetjes, atë të transportit dhe të furnizimit ushtarak. Për kolegët ishte një bashkëpunëtor i çmuar. Për miqtë ishte një njeri i rrallë. Për familjen ishte bashkëshorti, babai dhe gjyshi.

Për mua ishte edhe më shumë se kaq. Me Fahriun kam ndarë një pjesë të gjatë të rrugëtimit profesional. Kemi bashkëpunuar në detyra, plane, operacione e misione; kemi përballuar së bashku situata që kërkonin profesionalizëm, koordinim dhe përgjegjësi. Por përtej punës, me kalimin e viteve u bëmë miq.

Ky shkrim lind nga ajo miqësi dhe nga bindja se një njeri që i shërbeu për kaq gjatë Forcave të Armatosura meriton të kujtohet ashtu siç jetoi: me punën që bëri, me njerëzit që formoi dhe me respektin që fitoi gjatë gjithë jetës së tij profesionale dhe njerëzore. Fahriu nuk është më mes nesh, por rrëfimi për të nuk fillon nga fundi. Fillon nga jeta.

Nga “Skënderbeu” tek uniforma e oficerit

Rrugëtimi i Fahriut nisi herët. Ai ishte pjesë e brezit të djemve që u formuan në Shkollën “Skënderbej”, ku kaloi katër vite të rëndësishme të rinisë së tij. Shokët e asaj kohe e kujtojnë si një nxënës të shkëlqyer në mësimet dhe si një djalë të mirë në marrëdhëniet me shokët dhe njerëzit përreth.

Një prej tyre ishte i nderuari Pandeli Bardhi. Dekada më vonë, në çastin e lajmit të hidhur, Pandeliu e kujtoi Fahriun me dhimbjen e një shoku të vjetër, por edhe me mirënjohjen për një miqësi që kishte mbijetuar përtej viteve dhe rrugëve të ndryshme që kishte marrë jeta. Në fjalët e tij, Fahriu ishte “njeriu me zemër të bardhë, me shpirt human, me pastërti shpirtërore dhe me atë buzëqeshje të veçantë që i buronte natyrshëm”.

Është një dëshmi e thjeshtë, por domethënëse. Karakteri i një njeriu shpesh duket që në vitet e para të formimit, dhe miqësitë e krijuara në rini, kur janë të vërteta, i rezistojnë kohës. Jeta mund t’i çojë njerëzit në rrugë të ndryshme, por kujtimi i një shoku të mirë nuk zbehet. Fahriu kishte qenë një prej atyre shokëve që nuk harrohen.

Ai do të vazhdonte rrugën e tij në fushën e inxhinierisë dhe të shërbimit ushtarak, duke ndërtuar gradualisht një profil që do ta shoqëronte gjatë gjithë karrierës: specialist, planifikues, organizator dhe drejtues.

Inxhinieri dhe oficeri i transportit

Një pjesë e rëndësishme e karrierës së Fahriut lidhet me transportin ushtarak. Në Gjadër shërbeu si oficer i shërbimit të transportit në Regjimentin e Aviacionit. Më pas kaloi në Shtabin e Përgjithshëm, ku do të kalonte një pjesë të gjatë dhe të rëndësishme të karrierës së tij.

Rrugëtimi i tij në Shtabin e Përgjithshëm ishte një shkallë e ngjitur hap pas hapi, me punë dhe me rezultate. Filloi si ekspert dhe specialist i fushës së transportit, vazhdoi si oficer shtabi, u ngrit në drejtues dege dhe më pas në zëvendësdrejtor, duke u promovuar në vazhdimësi deri në detyrën e komandantit të brigadës dhe të komandantit të bazës më të madhe të furnizimit

FAHRI HIMA, NJË EMËR I SHKRUAR NË HISTORINË E TRANSPORTIT USHTARAK

Një jetë mes uniformës, përgjegjësisë, profesionit dhe miqësisë



ushtarak në vend.

Nuk ishte një karrierë e ndërtuar mbi rrethana. Ishte një karrierë e ndërtuar mbi kompetencë. Në çdo hallkë të kësaj shkalle, nga specialisti te komandanti, Fahriu mbante përgjegjësi gjithnjë e më të mëdha në organizimin, drejtimin dhe realizimin e proceseve të transportit dhe të mbështetjes logjistike.

Transporti ushtarak është një prej atyre fushave që shpesh nuk shihet nga jashtë, por pa të shumë prej detyrave të një force të armatosur nuk mund të realizohen. Pas çdo lëvizjeje qëndron një plan; pas çdo plani një përlogaritje; pas çdo përlogaritjeje një punë e ndërlikuar koordinimi.

Fahriu e njihte transportin jo thjesht si lëvizje mjeteshe, por si një sistem të tërë planifikimi, organizimi, koordinimi dhe kontrolli. Kjo aftësi do të merrte rëndësi të veçantë gjatë viteve të transformimit dhe ristrukturimit të Forcave të Armatosura.

Vitet e mëdha të transformimit

Pas vitit 1992 Forcat e Armatosura shqiptare hynë në një periudhë transformimi të thellë. Ndryshonin strukturat, riorganizoheshin kapacitetet, zhvendoseshin njësitë dhe rishikoheshin mënyrat e organizimit dhe të drejtimit. Në të njëjtën kohë Shqipëria kishte nisur një rrugëtim të ri strategjik drejt integritetit euroatlantik.

Në këtë proces një dimension i rëndësishëm ishte edhe organizimi i lëvizjeve të njerëzve, mjeteve, armatimit,

municioneve dhe pajisjeve ushtarake. Këtu transporti merrte një rëndësi të veçantë.

Planet dhe urdhrat për këto procese nuk ishin çështje të një niveli të ngushtë taktik. Në shumë raste ato kishin karakter strategjik dhe përfshinin struktura të niveleve të ndryshme të Forcave të Armatosura: divizione, brigada, regjimente dhe struktura të tjera. Për këtë arsye realizimi i tyre kërkonte një shkallë të lartë koordinimi ndërinstitucional. Kur bëhej fjalë për procese mobilizimi, koordinimi shtrihej edhe përtej strukturave ushtarake, duke përfshirë strukturat vendore dhe institucionet që kishin përgjegjësi në territor.

Në këtë realitet kompleks puna e specialistit të transportit nuk ishte thjesht të përcaktonte se cili mjet do të lëvizte nga një pikë në tjetrën. Duhej parë e gjithë tabloja: strukturat e përfshira, destinacionet, kapacitetet, mjetet, personeli, koha, rrugët e lëvizjes dhe ndërvarësitë midis hallkave të ndryshme.

Fahriu ishte një prej profesionistëve që e përballonte këtë përgjegjësi me seriozitet dhe qetësi.

Aty ku plani takohet me realitetin

Kjo është pjesa e punës së Fahriut që mund ta dëshmojë nga afër.

Në detyrat e mia mbuloja fushën e armatimit dhe të

municionit. Për këtë arsye bashkëpunimi me strukturat e transportit ishte i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm.

Në të gjitha fazat e ristrukturimit të Forcave të Armatosura na duhej të hartonim plane për përqendrimin, zhvendosjen dhe dislokimin e armëve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake. Pas hartimit të planeve të transportit duhej të përcaktoheshin destinacionet, të saktësoheshin mjetet që do të përdroeshin dhe drejtuesit e tyre, si dhe të koordinoheshin masat për realizimin e lëvizjeve.

Por puna nuk përfundonte me hartimin e planit.

Fahriu, së bashku me ekspertët e fushave përkatëse, ndiqte dhe monitoronte zbatimin e tij deri në përfundim. Dhe në shumë raste realiteti kërkonte ndryshime të ndjeshme gjatë vetë procesit: ndryshime në drejtimin e lëvizjes, në destinacion, në mënyrën e transportit apo në ngarkesat që duhej të zhvendoseshin.

Në situata të tilla, ku koha ishte e kufizuar dhe përgjegjësia e madhe, Fahriu ruante një qetësi të veçantë. E analizonte situatën, koordinonte me specialistët, gjente zgjidhjen dhe e orientonte procesin drejt përfundimit të suksesshëm.

Kjo ishte një prej cilësive që e dallonte si profesionist: nuk ishte thjesht hartues i një plani, por njeri që e ndiqte atë deri në realizimin e plotë.

E kam parë Fahriun edhe në procese të tjera, përfshirë mobilizimin e strukturave dhe të personelit. Edhe aty roli i tij nuk kufizohej te hartimi i planit. Ai ishte i pranishëm në planifikim, koordinim, monitorim dhe ndjekje deri në përfundimin e operacionit apo misionit të caktuar.

Kjo mënyrë pune e bënte të besueshëm. Kur punoje me Fahriun, e dije se detyra do të ndiqej. Nëse lindte një problem, ai nuk e shmangte. Nëse duhej ndryshuar një zgjidhje, ai e ndryshonte. Nëse kërkohej një koordinim i ri, e ndërtonte. Dhe mbi të gjitha, nuk e humbiste qetësinë.

Ishte një profesionist me njohuri të gjera, me një përvojë që shtrihej përtej kufijve të ngushtë të specialitetit të tij. Për këtë arsye, jo pa të drejtë, shumë prej nesh e shihnin si një lloj “enciklopedie” të gjallë të fushave ku kishte punuar. Por dija e tij nuk ishte vetëm teorike. Ajo ishte dije e kthyer në veprim, në vendimmarrje dhe në rezultat.

Nga specialisti te komandanti, një karrierë e ndërtuar mbi kompetencë

Fahri Hima në detyrë, në Shtabin e Përgjithshëm, në brigadë ose në bazën e furnizimit

Drejtuesi dhe lideri, autoriteti që fitohet, jo që jepet

Ngjitja e Fahriut nga specialisti tek komandanti i brigadës dhe i bazës më të madhe të furnizimit ushtarak nuk ndryshoi mënyrën se si sillej me njerëzit. Dhe pikërisht këtu qëndron dallimi mes një drejtuesi dhe një lideri.

Drejtuesi ka detyrën. Lideri ka njerëzit. Detyra jepet me urdhër; njerëzit fitohen me kohë, me shembull dhe me drejtësi. Fahriu i kishte të dyja, por e dyta ishte ajo që e bënte të veçantë.

Ata që kanë punuar me të flasin për një drejtues autoritar, por të drejtë; kërkues në punë, por njerëzor me vartësit. Ky ekuilibër është i vështirë për t’u ruajtur në një institucion ushtarak, ku hierarkia e bën të lehtë të komandosd dhe të vështirë të udhëheqësh. Autoriteti nuk fitohet vetëm nga grada apo detyra. Fitohet nga profesionalizmi, drejtësia dhe mënyra se si sillesh me njerëzit.

Lidershipi i Fahriut kishte disa tipare që përsëriten në kujtimet e atyre që punuan me të.

Së pari, kompetenca. Ai nuk kërkonte nga vartësit diçka që nuk e dinte vetë. E njihte transportin dhe furnizimin nga specialisti deri te komandanti, dhe kjo dije i jepte të drejtën morale të ishte kërkues.

Së dyti, qetësia. Në situata ku të tjerët ngrinin zërin, ai ulte tonin. Vartësit e dinin se te Fahriu do të gjenin një njeri që analizon, jo që fajëson.

Së treti, korrektësia dhe ndershmëria. Një prej vartësve të tij të dikurshëm e ka përmbledhur në këto dy fjalë atë që mësoi prej tij: “korrektësinë dhe ndershmërinë”. Në fund, këto janë edhe dy nga vlerat mbi të cilat ndërtohet besimi në një strukturë ushtarake.

Së katërti, përkushtimi ndaj njerëzve që formonte. Fahriu kishte një kujdes të veçantë për oficerët e rinj. I pëlqente t’u transmetonte përvojën, t’i këshillonte dhe t’i ndihmonte në rritjen e tyre profesionale. Ai e kuptonte se një lider nuk matet vetëm me rezultatet që arrin vetë, por edhe me njerëzit që lë pas. Në këtë kuptim, një pjesë e trashëgimisë së tij profesionale nuk ndodhet në dokumente apo në arkiva. Ajo ndodhet te njerëzit që punuan me të dhe që sot vazhdojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura.

Kështu, kur flasim për leadershipin e Fahriut, nuk flasim për një stil të mësuar nga librat. Flasin për një mënyrë të natyrshme të qenit me njerëzit: i drejtë kur duhej vendosur, i qetë kur duhej zgjidhur dhe njerëzor gjithmonë.

Shoku i punës, shoku i jetës

Një nga njerëzit që e njohu Fahriun nga shumë afër është inxhinier nënkolonel (R) Veip Bello. Të dy kanë punuar gjatë së bashku në Shtabin e Përgjithshëm, në fushën e transportit dhe të furnizimit ushtarak. Kanë ndarë detyra, përgjegjësi, probleme profesionale dhe vite të tëra shërbimi. Por marrëdhënia e tyre nuk përfundoi me uniformën. Edhe pas daljes në pension ata vazhduan të ishin pranë njëri-tjetrit. “Shokë në punë, shokë në jetë”, thotë Veipi.

Ai e përshkruan Fahriun si “një bashkëpunëtor të shkëlqyer, një profesionist plot talent, një shok ideal dhe një familjar

shembullor”. Por Veipi sjell edhe një pamje tjetër të karakterit të Fahriut, atë të njeriut në shoqëri: “Fahriu ishte i veçantë edhe mes miqsh. Shërbente si një lloj katalizatori edhe në ato raste kur të tjerët rrëmbeheshin nga diskutimet apo emocionet. Kishte një qetësi që ndikonte te të gjithë”.

Dhe pastaj shton një fjalë që thotë më shumë se një faqe e tërë: **“Nuk e pamë asnjëherë të ngrinte zërin”. Fahriu nuk kishte nevojë të ngrinte zërin për të fituar respekt.** Qetësia e tij ishte një formë force. Veipi sjell edhe një tjetër dimension të identitetit të Fahriut: “Ai ishte një devolli 24 karatësh. **E donte shumë Devollin dhe e përfaqësoi me dinjitet edhe nëpërmjet shoqatës ‘Devolli’.** Ishte krenar për vendin prej nga vinte dhe për njerëzit e tij”. Në fjalët e Veipit shfaqet kështu një Fahri tjetër: jo vetëm oficeri, inxhinieri dhe drejtuesi, por shoku që mbeti shok edhe pasi detyra mbaroi.

Intelektuali në uniformë


Në kujtimet e kolegëve të tij përsëritet shpesh edhe një tjetër cilësi: Fahriu ishte intelektual. Ishte njeri i kulturuar, i artikuluar dhe me një botë të pasur mendore. Nuk fliste për të mbushur heshtjen. E dëgjoje sepse kishte diçka për të thënë.

Por ajo që e bënte edhe më të veçantë ishte mënyra e tij e komunikimit. Qetësia, buzëqeshja, humori dhe mirësia e tij krijonin një afërsi të natyrshme me njerëzit. Këtë e ndienin oficerët e rinj që formoheshin pranë tij, dhe këtë e ndienim ne, kolegët e tij.

Kafenë me Fahriun shumë prej nesh do ta kujtojnë gjatë. Jo për kafenë vetë, por për bisedën që e shoqëronte. Për atë çast të thjeshtë ku një koleg bëhej mik, ku një diskutim për punën kalonte te jeta dhe ku, pa e kuptuar, një takim i zakonshëm bëhej kujtim.

Një jetë edhe përtej detyrës

Uniforma ishte një pjesë e rëndësishme e jetës së Fahriut,



por nuk ishte e gjithë jeta e tij. Pas kolonelit, inxhinierit, specialistit, planifikuesit dhe drejtuesit ishte një njeri i qetë, i kulturuar, zemërbutë dhe fisnik. Një njeri i dashur me shokët, i sinqertë dhe shoqëror, gjithmonë i gatshëm të ndihmonte.

Prandaj, kur sot flasim për të, nuk mund të mjaftohemi me funksionet dhe detyrat që mbajti. Duhet të flasim edhe për njeriun. Dhe ndoshta këtu qëndron dallimi më i madh mes një karriere të mirë dhe një jete me gjurmë. Karriera mbaron. Detyra mbaron. Uniforma hiqet. Por karakteri mbetet.

Në fund të jetës së tij Fahriu po përfundonte edhe një libër. Një tjetër dëshirë që mbeti përgjysmë. Nuk pati kohë ta mbyllte atë kapitull. Ndoshta një ditë do të gjenden njerëz që do ta cojnë deri në fund. Nëse kjo ndodh, libri do të jetë më shumë se një botim. Do të jetë një mënyrë për të ruajtur mendimet, përvojën dhe kujtesën e një njeriu që jetoi gjatë në një periudhë të rëndësishme të historisë së Forcave të Armatosura shqiptare.

Njeriu i familjes

Fahriu lë pas bashkëshorten e tij, Meritën, dhe djalin e tij, Albin, që jeton me familjen e tij në Francë.

Për familjen humbja nuk mund të matet me gradat, detyrat apo vlerësimet profesionale. Aty mungon bashkëshorti. Aty mungon babai. Aty mungon gjysh. Prandaj fjalët e ngushëllimit janë gjithmonë të vogla përballë një dhimbjeje të tillë.

Por familja mund të ketë një ngushëllim: të dijë se njeriu i tyre la pas një emër të mirë dhe respektin e shumë njerëzve që patën fatin ta njohin.

Përtej uniformës: njeriu, familjari, miku

Fahri Hima në jetën civile, me familjen ose me miqtë

Në Ditën e Transportit

Sot, kur kujtojmë Fahriun në një ditë që lidhet me profesionin, të cilit i kushtoi një pjesë të madhe të jetës, Festa e Transportit merr edhe një dimension tjetër. Është një ditë për të nderuar një shërbim pa të cilin asnjë forcë e armatosur nuk mund të funksionojë siç duhet. Por është edhe një ditë për të kujtuar njerëzit që ia kushtuan jetën kësaj fushe. Fahriu ishte një prej tyre.

Ai nuk e kërkoj zhurmën. Nuk ishte njeri që kërkonte të ishte në qendër të vëmendjes. Për të puna ishte dëshmia më e mirë. Dhe puna e tij flet.

Fahri Hima ka lënë emrin e tij në historinë e transportit ushtarak shqiptar. Jo përmes fjalëve të mëdha, por përmes punës. Përmes planeve. Përmes koordinimit të strukturave. Përmes lëvizjeve të realizuara. Përmes detyrave të përfunduara. Përmes problemeve të zgjidhura. Përmes njerëzve që drejtoi dhe oficerëve të rinj që ndihmoi të formoheshin. Dhe, mbi të gjitha, përmes mënyrës së tij të veçantë për ta çuar çdo detyrë deri në fund.

Shumë prej ushtarakëve që do ta lexojnë këtë shkrim ndoshta nuk e kanë njohur nga afër. Por të gjithë janë pjesë e një sistemi, një kulture pune dhe një tradite profesionale ku kanë lënë gjurmë njerëz si Fahriu. Kjo është edhe arsyeja pse kujtimi i tij nuk duhet të mbetet vetëm kujtim familjar. Ai është pjesë e kujtesës profesionale të Forcave të Armatosura.

Dhe tani, vetëm Fahriu

Në fund dua ta lë mënjanë kolonelin. Të lë mënjanë inxhinierin. Të lë mënjanë specialistin e transportit, planifikuesin dhe drejtuesin.

Dua të kujtoj Fahriun. Mikun. Njeriun me buzëqeshjen e tij të veçantë. Njeriun me të cilin mund të flisje gjatë dhe të largoheshe prej bisedës me më shumë optimizëm. Njeriun që dinte të sillte qetësi edhe në situatat e vështira. Dhe mikun me



të cilin, për fat të keq, nuk e pimë atë kafe që e lamë për një ditë tjetër.

Në ditët e ndarjes, mes qindra mesazheve që u shkruan për të në rrjetet sociale, një prej miqve të tij la vetëm një fjalë: “Peng që nuk piva një kafe me ty muajin e fundit”. Edhe unë do ta dëshiroja kafen e fundit me të Madhin Fahri.

Ndoshta këto janë ndër fjalët më të dhimbshme që mund të shkruhen për një mik. Sepse në jetë mendojmë gjithmonë se do të ketë një herë tjetër. Një takim tjetër. Një kafe tjetër. Një bisedë tjetër. Derisa vjen një ditë kur kupton se ajo që e quajte “herën tjetër” ishte në të vërtetë hera e fundit.

Fahri, sot, duke parë fotografitë e tua me uniformë dhe në jetën civile, shoh të njëjtin njeri: profesionistin e përkushtuar dhe njeriun e mirë. Dy anë të së njëjtës jetë. Një jetë të jetuar me dinjitet. Një jetë që la gjurmë.

Do të na mungosh. Por emri yt nuk do të largohet bashkë me ty. Do të mbetet në kujtesën e atyre që punuan me ty, të atyre që mësuam prej teje, të miqve të rinisë, të kolegëve dhe të Forcave të Armatosura. Do të mbetet në familjen tënde dhe në zemrat e njerëzve që patën fatin të të njohin.

Ndoshta kjo është mënyra më e drejtë për ta matur një jetë: jo me vitet që jetuam, por me gjurmët që lamë. Dhe Fahriu la gjurmë. Të thella. Profesionale. Njerëzore. Të mira.

Prandaj sot nuk dua të them vetëm se u nda nga jeta një kolonel. Dua të them se Forcat e Armatosura humbën një profesionist të rrallë, ndërsa ne humbëm një njeri të mirë, një koleg të vyer dhe një mik të paharruar. Një njeri që e jetoi detyrën me përgjegjësi, profesionin me përkushtim dhe miqësinë me zemër.

Fahri Hima. Një emër i shkruar në historinë e transportit ushtarak. Një emër që koha nuk duhet ta harrojë.

Nga larg, miku yt i përjetshëm.

BRIKEN CALJA, DY MEDALJE DHE NJË FLAMUR NË MAJË TË PODIUMIT

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

NË TARANTO U NGJIT FLAMURI, NË PEDANË SHKËLQEU KOLONEL BRIKEN CALJA
Sporti pushon së qeni vetëm sport, kur ai vishet me ngjyrat kuq e zi, kur një peshë e ngritur mbi kokë bëhet më shumë se një rezultat. Kur një medalje nuk është vetëm një medalje. Kur himni kombëtar që dëgjohet në një arenë ndërkombëtare nuk është thjesht pjesë e ceremonisë, por një emocion që përmbledh në pak minuta punën, sakrificën, disiplinën dhe krenarinë e një kombi. **Taranto 2026 ishte një prej atyre momenteve.**

Paraditen e 1 shtatorit, në Lojërat Mesdhetare, flamuri shqiptar u ngjit sërish në podium falë një prej emrave më të njohur të peshëngritjes shqiptare: **Briken Caljës.**

Në kategorinë deri në 75 kilogramë, shqiptari triumfoi në stilin e shkëputjes, duke ngritur **154 kilogramë** dhe duke vendosur rekord të ri të Lojërave Mesdhetare. Në stilin e shtytjes, ai realizoi 184 kilogramë dhe fitoi medaljen e bronzit. Dy stile, dy medalje, një tjetër faqe e artë për Shqipërinë.

Por për gazetën **“Ushtria”**, kjo histori ka edhe një dimension tjetër.

Sepse në podiumin e Tarantos nuk ishte vetëm një kampion i madh i sportit shqiptar. Ishte edhe **Kolonel Briken Calja**, sportisti i elitës kombëtare që prej vitit 2023 mban gradën honorifike “Kolonel” dhe është bërë pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Dhe kjo e bën suksesin e tij një histori që i përket edhe familjes së madhe të Forcave të Armatosura.

154 kilogramë që ngritën flamurin
Në sportin e peshëngritjes, 154 kilogramë nuk janë thjesht një shifër. Pas tyre qëndrojnë vite pune, përsëritje, stërvitje, dhimbje, sakrificë dhe një disiplinë që nuk fal. Calja e nisi garën në shkëputje me 147 kilogramë. Në provën e dytë kaloi me sukses 152 kilogramë. Pastaj erdhi prova e tretë. **154 kilogramë.**

Një ngritje e suksesshme që i dha medaljen e artë dhe rekordin e ri të kompeticionit.

Në shtytje, gara ishte po aq e fortë. Pas një tentative të pasuksesshme me 183 kilogramë, Calja u rikthye dhe realizoi 184 kilogramë, rezultat që i dha medaljen e bronzit. Në fund, dy medalje. **Ari dhe bronzi.**

Dy ngjyra të medaljeve që në Taranto morën një ngjyrë të tretë në kuptimin e tyre: **kuqezi.**

Kur sporti takohet me uniformën
Në historinë e Forcave të Armatosura, uniforma ka qenë gjithmonë simbol i detyrës. Por ka edhe një uniformë tjetër që Shqipëria e njeh mirë, ajo e sportistit kombëtar. Në të dyja rastet kërkohet disiplinë. Në të dyja rastet kërkohet sakrificë. Në të dyja rastet flamuri nuk është një detaj ceremonial. **Është arsyeja.**

Në prill 2023, Briken Calja ishte ndër shtatë kampionët olimpike, botërorë dhe europianë që u nderuan me gradën “Kolonel” dhe iu bashkuan Forcave të Armatosura. Në ceremoninë zyrtare u theksua pikërisht pika e përbashkët mes elitës sportive dhe ushtarakëve: **flamuri shqiptar dhe dashuria për vendin.**

Që nga ajo ditë, emri i Briken Caljës lidhet në një mënyrë të veçantë edhe me Forcat e Armatosura. Dhe sa herë ai ngjitet në podium me flamurin kuqezi, kjo lidhje merr një kuptim të ri.

Një kolonel në pedanë
Në pamje të parë, pedana e peshëngritjes dhe fusha e shërbimit ushtarak duken si dy botë të ndryshme. Njëra ka pesha. Tjetra ka detyrën. Njëra mat forcën në kilogramë. Tjetra mat qëndrueshmërinë, profesionalizmin dhe përgjegjësinë.

Por në thelb kanë një gjuhë të përbashkët: **disiplinën.**
Një sportist elitar nuk bëhet kampion brenda një dite. As një ushtarak profesionist nuk formohet brenda një ceremonie. Të dy ndërtohen përmes përgatitjes. Përmes përsëritjes. Përmes aftësisë për t’u ngritur pas një dështimi. Dhe pikërisht kjo e bën figurën e Briken Caljës veçanërisht domethënëse për faqet e gazetës “Ushtria”. Ai është një kampion që ka mbajtur flamurin shqiptar në skenat më të mëdha të sportit dhe njëkohësisht një **Kolonel honorifik i Forcave të Armatosura.**

Një lidhje simbolike mes dy botëve që kanë të njëjtën pikë referimi. **Shqipërinë.**

Nga Tirana në Taranto, i njëjti flamur
Historia e sportit shqiptar është ndërtuar mbi momente kur një flamur i vogël në përmasa është bërë i madh në sytë e botës. Peshëngritja ka qenë një prej atyre sporteve që e ka bërë këtë flamur të ngrihet shumë herë. Briken Calja është



një nga emrat e kësaj tradite. Por ajo që ndodhi në Taranto nuk është thjesht vazhdim i një statistike. **Është dëshmi se kampionët nuk jetojnë vetëm nga kujtimet e fitoreve të mëparshme.**

Ata rikthehen. Provojnë përsëri. Ngrenë peshën.

Dhe, kur ajo qëndron lart, bashkë me të ngrihet edhe flamuri. Në Taranto, 154 kilogramët e Caljës sollën jo vetëm një medalje ari, por edhe një rekord të ri të kompeticionit. Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, kryeministri z. Edi Rama dhe ministri i Mbrojtjes z. Ermal Nufi e përshëndetën suksesin duke e cilësuar rekordin një arritje që bën krenar Shqipërinë.

Më shumë se një medalje
Në sport, medaljet numërohen. Por disa medalje kanë një peshë tjetër. Ato vijnë në një moment kur vendi ka nevojë për arsye për të buzëqeshur. Kur mijëra njerëz ndjekin një garë dhe presin atë çastin kur himni do të dëgjohet. Në Taranto, ai himn u dëgjua për Shqipërinë. Dhe pas tij ishte puna e një sportisti.

Por për ne, si **shtyp ushtarak**, ishte edhe një kujtesë e bukur e asaj që përfaqëson uniforma kur ajo bashkohet me talentin, disiplinën dhe përfaqësimin kombëtar.

Forcat e Armatosura nuk janë vetëm struktura, institucione dhe kapacitete. Janë edhe njerëzit. Janë ata që në fusha të ndryshme i shërbejnë emrit të Shqipërisë.

Në këtë kuptim, kampionët shqiptarë që janë nderuar me grada honorifike janë bërë pjesë e një mesazhi të rëndësishëm: **Shërbimi ndaj vendit ka shumë forma.** Dikush e kryen detyrën në uniformë. Dikush ngjitet në një pedanë. Por kur të dy bëjnë gjithçka për flamurin, rrugët e tyre takohen.

Koloneli që nuk e ul peshën
154 kilogramë u ngritën mbi kokë. Por ajo që mbetet pas një rekordi nuk është vetëm pesha. **Është karakteri që e bëri**



të mundur. Është aftësia për të besuar edhe pas provës së parë. Është guximi për të provuar më shumë. Është qetësia për të qëndruar përballë presionit. Është respekti për flamurin që mban në gjoks. Këto janë vlera që sporti dhe Forcat e Armatosura i njohin mirë.

Prandaj sot, në faqet e “Ushtrisë”, Briken Calja nuk vjen vetëm si kampioni që fitoi dy medalje në “Taranto 2026”. Vjen si **Kolonel Briken Calja**. Si një sportist që e ka ngritur emrin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Si një kampion që e ka bërë pedanën një vend ku flamuri shqiptar ngrihet me dinjitet.

Dhe si një pjesëtar honorifik i Forcave të Armatosura, që na kujton se **atdheu nuk përfaqësohet vetëm në uniformën e gjelbër të ushtarakut, por kudo ku një shqiptar ngre flamurin e tij me profesionalizëm, disiplinë dhe krenari.**

ARI, BRONZI DHE KUQEZIA
Dy medalje në Taranto. Një rekord i ri. 154 kilogramë në shkëputje. 184 kilogramë në shtytje. **Por mbi të gjitha, një himn. Një flamur. Një emër. Briken Calja.**

Dhe një uniformë që, edhe kur nuk është në pedanë, është pjesë e historisë së këtij kampioni. Sepse pesha më e rëndë nuk është ajo që ngrihet me duar. **Është përgjegjësia për të mbajtur lart emrin e Shqipërisë.** Dhe në Taranto, Kolonel Briken Calja e mbajti lart.

Bekuar qofshin, të rinjtë e të rejtat!
Ju që e ngrini me **dinjitet, krenari dhe dashuri flamurin kombëtar**, nuk mbani vetëm një simbol në duar, mbani historinë, sakrificën dhe shpresën e një kombi. Në çdo hap tuajin, në çdo fitore e në çdo përfaqësim të Shqipërisë, **kuq e ziu bëhet më i bukur dhe Shqipëria më krenare.**

Udhëtimi juaj qoftë gjithmonë i bekuar, zemrat plot atdhedashuri dhe ëndrrat të mëdha sa vetë flamuri që mbani lart.

Bekuar flamuri kuq e zi!
Bekuar ju, bij e bija të Shqipërisë, që dini ta nderoni atë!



SKËNDERBEGAS: PASAPORTË E VLERAVE ATDHETARE

Një rrëfim për një shkollë që nuk mbylli vetëm dyer, por hapi rrugë për jetë të tëra

Ndodh që godinat me kalimin e viteve ndryshojnë, mbyllen apo mbeten vetëm në fotografi, por ka vlera që nuk shemben bashkë me muret. Ato mbeten te njerëzit, në kujtesën e tyre, në profesionin që zgjedhin dhe në mënyrën se si e jetojnë përgjegjësinë ndaj vendit.

Shtypi ushtarak shqiptar ka qenë për dekada një nga dëshmitarët e kësaj historie. Në faqet e tij kanë gjetur vend breza njerëzish me uniformë, komandantë e ushtarë, pedagogë e nxënës, gra e burra që kanë shërbyer në Forcat e Armatosura dhe që, në mënyra të ndryshme, kanë lënë gjurmën e tyre në jetën e vendit.

Gazeta **“Ushtria”** nuk ka qenë vetëm kronikë e stërvitjeve, operacioneve, ceremonive apo veprimtarisë së institucioneve ushtarake. Ajo ka qenë edhe **kujtesë**. Ka ruajtur emra, histori, përvoja dhe dëshmi njerëzore. Ka ndjekur rrugëtimin e një brezi që e ka njohur uniformën si detyrë, por edhe si shkollë karakteri.

Në këtë kuptim, të shkruash sot për **Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”** nuk do të thotë thjesht të rikthehesh në një faqe të së kaluarës. Do të thotë të dëgjosh zërin e atyre që e kanë përjetuar atë kohë dhe të pyesësh se çfarë mbetet prej saj në kujtesën e njerëzve.



NËNKOLONEL (R) AGIM LIKA
Nënkoloni (R), poet dhe studiues

Sa herë që më bie rasti të shkruaj për Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, e ndiej se po kthehem pas në kohë. Jo thjesht në një periudhë të largët të rinisë sime, por në një pjesë të rëndësishme të jetës, në atë pjesë ku u formuan shumë prej vlerave që më shoqëruan më pas.

Kam qenë nxënës i kësaj shkolle. E kam jetuar atë nga afër, me gjithë bukurinë, vështirësitë, disiplinën dhe emocionet e saj. Prandaj, kur flas për “Skënderbeun”, nuk flas vetëm nga ato që kam lexuar apo dëgjuar më vonë. Flas edhe nga kujtesa ime. Nga ajo që kam parë, kam përjetuar dhe kam ndier.

Më kujtohet oborri i shkollës, uniforma, rreshti i mëngjesit, zëri i komandës, bankat e klasës, mësuesit, komandantët dhe, mbi të gjitha, shokët me të cilët ndamë ato vite.

Më kujtohen ditët e gjata, mësimet, provimet, stërvitjet, aksionet, garat, lodhja, gëzimet e vogla dhe vështirësitë që në atë moshë na dukeshin shumë më të mëdha nga ç’ishin në të vërtetë.

Atëherë nuk e kuptonim gjithmonë se çfarë po merrnim me vete nga ajo përvojë.

Sot e kuptojmë më mirë.

Ajo shkollë nuk na dha vetëm dije dhe përgatitje profesionale. Na mësoi të jetonim me rregull, me përgjegjësi, me punë dhe me respekt për tjetrin. Na mësoi të përballonim vështirësitë dhe të mos dorëzoheshim lehtë. Dhe, ndoshta, më e rëndësishmja: na dha një përvojë që nuk përfundoi ditën kur dolëm nga dyert e saj. Ajo vazhdoi të jetonte brenda nesh.

Një pjesë e rinisë sime

Kur mendoj sot për ato vite, më shumë se godina më vijnë ndër mend njerëzit. Më vijnë ndër mend shokët. Disa prej tyre i kam ende pranë. Me disa të tjerë jeta na ka shpërndarë nëpër rrugë të ndryshme. Disa nuk janë më mes nesh. Por asnjëri prej tyre nuk është zhdukur plotësisht nga kujtesa ime.

Kjo është një nga mrekullitë e rinisë: ajo mund të largohet në kohë, por nuk largohet lehtë nga shpirti.

Një shkollë nuk të lidh vetëm me librat, mësimet dhe provimet. Të lidh me njerëzit me të cilët ke ndarë një copë jete. Me ta ke ndarë të qeshurat dhe lodhjen, sukseset dhe dështimet, frikën dhe guximin, ëndrrat dhe pasiguritë e moshës.

Ne ishim të rinj. Kishim ëndrra, ambicie dhe shumë pyetje për të ardhmen. Secili e imagjinonte jetën në mënyrën e vet.

Pastaj erdhi jeta. Dhe jeta na çoi në drejtime të ndryshme. Disa vazhduan karrierën ushtarake. Të tjerë u morën me arsim, shkencë, administratë, sport, kulturë apo profesione të tjera. Secili ndërtoi rrugën e vet. Por një gjë na mbeti e përbashkët: **kujtesa e Shkollës “Skënderbej”**.

Çfarë na mësoi Shkolla “Skënderbej”?

Sot, pas kaq vitesh, e shoh më qartë se formimi që morëm atje ishte më i gjerë se një përgatitje profesionale. Dija ishte e rëndësishme, por nuk ishte e vetme. Krahas dijes ishin disiplina, puna, përgjegjësia dhe bashkëjtesa me të tjerët.

Në atë moshë, disiplina ndonjëherë na dukej e vështirë. Sot e kuptoj se një pjesë e madhe e saj na shërbeu më vonë në jetë. Na mësoi të respektonim kohën. Të kryenim detyrën. Të mos i shmangeshim përgjegjësisë. Të përballonim vështirësitë. Të punonim edhe atëherë kur nuk kishim dëshirë.

Dhe ndoshta ky është një nga mësimet më të vlefshme që kam marrë. Sepse në jetë nuk bën gjithmonë atë që dëshiron. Shpesh duhet të bësh atë që duhet. Pikërisht aty fillon përgjegjësia.

Nuk dua ta shoh të kaluarën me sy të verbër

Duke shkruar sot për Shkollën “Skënderbej”, nuk dua ta idealizoj të kaluarën. Kam kaluar mjaft vite në jetë për ta kuptuar se asnjë periudhë nuk është vetëm bardhë apo vetëm zi. **Çdo kohë ka të mirat dhe kufizimet e veta.**

Edhe shkolla jonë duhet parë në kohën dhe në rrethanat historike në të cilat ka ekzistuar. Historia kërkon qetësi. Kërkon dokumente. Kërkon dëshmi. Dhe, mbi të gjitha, kërkon mendim kritik. Por të jesh kritik nuk do të thotë të mohosh gjithçka.

Përkundrazi. Do të thotë të dish të dallosh. Të thuash hapur çfarë ishte e mirë dhe çfarë nuk ishte. Të ruash atë që vlen dhe të mos përsërisësh atë që koha e ka provuar të gabuar.

Dija mbetet

Nëse do të më pyesnin se cila është vlera më e madhe që mund të marrë një njeri nga një shkollë, do të përgjigjesha pa hezitim: **Dija**.

Uniforma mund të mbetet në një fotografi. Një godinë mund të ndryshojë. Një institucion mund të mbyllet. Por dija që ke marrë nuk të ndahet lehtë. Ajo të shoqëron në profesion, në vendimmarrje dhe në jetën e përditshme. Sot, kur shoh se sa shumë ka ndryshuar bota, bindem edhe më tepër se Shqipëria ka nevojë për njerëz të ditur, profesionistë dhe me karakter. Sidomos në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, nuk mjaftojnë më vetëm forca fizike apo përvoja tradicionale. Duhet teknologji. Duhet kërkim shkencor. Duhet

Sepse historia nuk jeton vetëm në dokumente. Ajo jeton edhe në dëshmi.

Një oborr shkolle. Një uniformë. Një rresht mëngjesi. Zëri i komandës. Bankat e klasës. Mësuesit. Komandantët. Shokët. Ditët e gjata të mësimit dhe stërvitjes. Gëzimet e vogla dhe vështirësitë e moshës. Të gjitha këto, vite më vonë, marrin një kuptim tjetër.

Kjo është arsyeja pse gazeta “Ushtria” sjell në këto faqe rrëfimin e **Agim Likës, Nënkolonel (R), poet dhe studiues**, një prej atyre që e kanë jetuar nga afër përvojën e “Skënderbeut”. Rrëfimi i tij nuk kërkon ta idealizojë të kaluarën dhe as ta gjykojë atë me sytë e së tashmes. Ai kërkon të ruajë atë që vlen, dijen, disiplinën, përgjegjësinë, miqësinë, respektin për detyrën dhe dashurinë për vendin.

Është një dëshmi personale, por njëkohësisht edhe një dëshmi për një brez që u ul në bankat e një shkolle ushtarake si djalë i ri dhe doli prej saj me një tjetër kuptim të fjalëve detyrë, përgjegjësi, punë dhe karakter. Dhe ndoshta këtu qëndron edhe arsyeja pse kujtesa e “Skënderbeut” vazhdon të jetë e gjallë. Jo sepse koha duhet kthyer pas. Por sepse **çdo brez ka nevojë të dijë çfarë ka marrë me vete nga koha që ka jetuar.**

SKËNDERBEGAS – PASAPORTË E VLERAVE ATDHETARE

Një rrëfim personal për shkollën, shokët dhe vlerat që morëm me vete

arsim bashkëkohor. Duhet profesionalizëm. Dhe, mbi të gjitha, duhen njerëz me karakter.

Prandaj, kur mendoj për trashëgiminë e Shkollës “Skënderbej”, nuk mendoj për një kthim pas. **Mendoj për të ardhmen.**

Mendoj se vlerat e mira të asaj përvoje mund të shërbejnë si pikënisje për një model të ri, bashkëkohor, demokratik dhe meritokratik të formimit.

Atdheu, ashtu siç e kuptoj sot

Edhe fjala “atdhe” ka marrë një kuptim tjetër për mua me kalimin e viteve. Kur isha i ri, e mendoja më shumë si një ideal të madh. Sot e shoh edhe në gjërat e përditshme.

Atdheu është puna që bën. Është mënyra si e kryen detyrën. Është respekti që ke për njerëzit. Është përgjegjësia ndaj familjes dhe shoqërisë. Është ndershmëria me të cilën punon. Është dëshira për të lënë diçka të mirë pas vetes. Prandaj mendoj se atdheu nuk mbrohet vetëm në kufi.

Mbrohet edhe në klasë, në universitet, në laborator, në zyrë, në profesion dhe kudo ku një shqiptar përpiqet ta bëjë mirë detyrën e vet. **Atdhedashuria, për mua, nuk është zhurmë. Është vepër.**

Pse duhet ta ruajmë kujtesën?

Kjo është edhe një nga arsyet pse po shkruaj këtë libër. Ne po hyjmë në një moshë kur kujtimet nuk mund t'i lëmë më vetëm në kujtesën tonë. Duhet t'i shkruajmë. Duhet t'i mbledhim. Duhet t'i dokumentojmë. Sepse çdo vit që kalon, humbasim dikë që mund të tregonte një histori që askush tjetër nuk e di. Një mësues. Një komandant. Një shok klase. Një ish-nxënës. Një njeri që ka mbajtur mend një ngjarje të veçantë.

Prandaj fotografitë, dokumentet, dëftesat, albumet, kujtimet dhe dëshmitë personale nuk janë thjesht materiale të vjetra. **Ato janë pjesë e historisë.**

Dhe nëse nuk i ruajmë sot, nesër mund të jetë tepër vonë.

Pasaporta ime e vlerave

Titulli i këtij libri, “Skënderbegas – Pasaportë e Vlerave Atdhetare”, për mua ka një kuptim të veçantë.

Sepse pasaporta zakonisht tregon kush je. Por pasaporta ime si Skënderbegas nuk është një dokument.

Ajo është ajo që kam marrë me vete nga ajo shkollë: **Dija. Disiplina. Puna. Përgjegjësia. Miqësia. Respekti për detyrën. Dashuria për vendin.**

Këto janë, për mua, vultat e asaj pasaporte. Dhe besoj se secili prej nesh ka një të tillë.

Çfarë dua t’u lëmë brezave të rinj

Nuk dua që ky libër të lexohet vetëm si një libër nostalgjie. Do të doja që brezat e rinj të merrnin prej tij diçka më shumë. Të kuptonin se një shkollë nuk vlen vetëm për atë që të mëson në libra. Ajo vlen edhe për mënyrën se si të përgatit për jetën. Do të doja t’u thosha të rinjve: Mos kini frikë nga disiplina. Mos e ndani dijen nga karakteri. Mos e ndani lirinë nga përgjegjësia. Mos e ndani suksesin nga puna. Dhe mos e mendoni atdhedashurinë si një fjalë që duhet thënë shpesh. **Më mirë tregojeni me atë që bëni.**

Në fund mbetet kujtimi

Kur kthehem me mendje te vitet e Shkollës “Skënderbej”, nuk dua të kthehem pas në kohë. Koha nuk kthehet. Dhe ndoshta nuk duhet të kthehet. Por dua të ruaj atë që ajo kohë më dha. Dua të ruaj shokët. Të kujtoj mësuesit dhe komandantët. Të nderoj ata që nuk janë më. Të dokumentoj atë që mund të dokumentohet.

Dhe t’u them atyre që vijnë pas nesh se një pjesë e rëndësishme e jetës sonë u formua aty.

Për mua, “Skënderbegas” nuk është vetëm një emër. **Është një pjesë e biografisë sime. Është një pjesë e kujtesës sime. Është një pjesë e historisë së brezit tim.** Dhe ndoshta kjo është arsyeja pse, sa herë flas për të, e ndiej se nuk po flas vetëm për të kaluarën. Po flas edhe për veten. Për djalin që isha. Për burrin që u bëra. Për rrugën që përshkova. Për shokët që pata pranë. Për ata që mbetën pas. Për ata që ikën përgjithmonë. Dhe për vlerat që, në një mënyrë ose në një tjetër, i mora me vete nga ajo shkollë.

Prandaj mund ta them pa shumë fjalë: **Skënderbegas isha. Skënderbegas jam. Dhe Skënderbegas do të mbetem.**

Jo për të jetuar në të kaluarën. Por për të mos harruar se nga kam ardhur. Sepse disa shkolla mbyllin dyert. Disa godina ndryshojnë. Disa emra zbehen me kalimin e viteve. Por ajo që një shkollë të ka dhënë, nëse e ke ruajtur dhe e ke kthyer në vepër, **nuk mbyllet kurrë.**

Dhe në fund, ndoshta kjo është pasaporta më e mirë që mund t’i lëmë pas vetes: **një jetë e jetuar me dije, punë, karakter, përgjegjësi dhe dashuri për vendin.**

Kjo është pasaporta ime. Kjo është pasaporta jonë Kjo është pasaporta e Skënderbegasit.

SHKOLLA QË S’HARROHET KURRË

(poemth)

Kur kaluam portën, lamë fëmijërinë

Me ëndrra në zemër, me shpirtin zjarr

Aty e nisëm rrugën për burrërinë

Me hapa të sigurt, me ballin krenarë

Një jetë me rregulla të forta, na priti
Me zgjime të hershme, në rresht çdo ditë
Por çdo vështirësi forcoi si shkëmbi, na rriti
Dhe na bëri më të drejtë çdo sakrificë

Në pragun e saj lamë përkëdhelinë
Mbi supe morëm barrën e rëndë plumb
Aty mësuam besën, nderin, burrërinë
Shokun ta mbajmë pranë gjer në fund

Na mësonte që secili të ishte burrë
Çdo natë na provonte me heshtje, durim
Na thoshte detyra: “Mos u dorëzo kurrë!”
Se nderi i burrit s’ka kurrë një çmim

Me hapa të matur kalonim provat ne
Me ballin përpjetë, me zemrën zjarr
Në çdo vështirësi gjenim forcë të re
Dhe shoku përkrah na bënte më krenarë

Na dukej si burg shkolla, kur e kujtojmë
Me rregulla të rrepta, me ditë pambarim
Pas kaq shumë vitesh, sot e kuptojmë
Se aty karakteri ynë gjeti formim

Aty u kalitëm në zjarr e mundim
Aty mori formë besimi në jetë
Me punë, disiplinë, besë e durim
U bëmë të fortë për çdo gjë, burra të vërtetë

Aty mësuam fjalën e shenjtë: “Atdhe”
Dhe nderin që mbahet mbi çdo pasuri
Që burri nuk dorëzohet, mësuam ne
Kur jeta e provon me vështirësi

Nga ajo portë dolëm një ditë
Jo më si djemtë që hymë dikur si të hutuar
Në sytë tanë shkëlqente një tjetër dritë
Që zemrat të durojnë, kishin mësuar

Vitet kaluan si lumenj të tërbuar
Na shpërndau jeta në rrugë pa fund
Shokët e rinisë s’kemi për t’i harruar
Se vëllazëria rrënjëzoi thellë në trung

Sot, kujtojmë ato vite e jemi ballëllartë
Na zgjohet në zemër një mall i pashuar
Ajo portë na duket gjithnjë më e artë
Se aty breza të tërë janë farkëtuar

Shumë pragje, gjatë jetës, kemi kaluar
Me dhimbje, me sfida, me punë, fitore
Por ai i pari mbeti dritë e pashuar
Si kujtimi më i bukur i viteve rinore

Prandaj, skënderbegas, kudo që jemi
Një pjesë e rinisë na mbeti atje vërtetë
Edhe pse thinjat mbi kokë i kemi
Ajo portë na thërret si dikur, në jetë

Sot mund të jemi larg, dikush t’emigrojë
Por zemra s’i trembet kurrë largësisë
Shoku i vjetër, sado larg të shkojë
Mbetet gjithmonë pjesë e rinisë

Dhe nëse dikush na pyet një ditë
“Për gjithë këto vite, ç’ju lidhi kaq fort?”
Do t’i themi: “Një portë, një ëndërr, një dritë
Një rini që na lidhi dhe s’ndahemi dot”

Energjia bërthamore, një histori e mbylljeve dhe rikthimeve

Energjia bërthamore ka qenë për dekada një nga burimet më të diskutueshme të prodhimit të energjisë elektrike. Nga njëra anë, ajo ofron kapacitete të mëdha prodhimi pa emetuar gazra serrë; nga ana tjetër, aksidentet tragjike dhe mbetjet radioaktive kanë ushqyer frikën e publikut. Sot, panorama globale është e ndarë mes vendeve që kanë zgjedhur të mbyllin reaktorët e tyre dhe atyre që po investojnë fuqishëm në teknologji të reja.

Eksperiencat e kufizuara

Disa vende kanë pasur vetëm përvoja të shkurtra me energjinë bërthamore. Panama, Puerto Rico, Argentina, Holanda, Kazakistani, Pakistani, Armenia dhe Filipinet kanë mbyllur nga një reaktor secili, shpesh me kapacitete të vogla. Për këto vende, energjia bërthamore nuk ka qenë kurrë një pjesë thelbësore e strategjisë energjetike. Në Filipine, për shembull, reaktori i vetëm nuk u vu kurrë në funksionim të plotë, duke reflektuar shqetësimet e sigurisë dhe tensionet politike.

Mbyllje të moderuara, por me mbështetje të vazhdueshme

India, Sllovakia, Spanja, Koreja e Jugut, Italia, Bullgaria, Belgjika, Kanadaja, Lituania, Ukraina dhe Suedia kanë mbyllur disa reaktorë, por nuk kanë braktisur energjinë bërthamore.

India ka mbyllur katër reaktorë të vegjël, por sot operon mbi 20 dhe planifikon zgjerime të mëdha për të përballuar kërkesën në rritje.

Sllovakia ka mbyllur tre reaktorë, por mbetet një nga vendet më të varura nga energjia bërthamore në Europë.

Spanja ka mbyllur tre reaktorë, por ende shtatë të tjerë furnizojnë vendin, me një plan afatgjatë për daljen graduale.

Italia është një rast unik: pas referendumit popullor, vendi braktisi plotësisht energjinë bërthamore, duke u mbështetur tek importet dhe burimet alternative.

Bullgaria dhe Lituania i mbyllën reaktorët kryesisht për shkak të kërkesave të integritimit në Bashkimin European.

Ukraina, pavarësisht mbylljeve, mbetet një lojtar i madh me 15 reaktorë aktivë, edhe pse lufta dhe pushtimi i centralit të Zaporizhzhia e kanë vendosur sektorin nën vëmendje globale.

Suedia ka mbyllur shtatë reaktorë, por gjashtë të tjerë vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e miksit energjetik.

Vendet me mbyllje masive


Në krye të listës qëndrojnë fuqitë e mëdha industriale:

Gjermania ka mbyllur 36 reaktorë me kapacitet 27,862 MW, duke përfunduar zyrtarisht daljen nga energjia bërthamore në vitin 2023. Ky vend dikur siguronte një të tretën e energjisë nga bërthamorja, por pas katastrofës së Fukushima's, politika ndryshoi rrënjësisht.

Mbretëria e Bashkuar ka mbyllur gjithashtu 36 reaktorë, kryesisht për arsye teknike, me një kapacitet prej mbi 9,000 MW. Sot operon vetëm nëntë, por ka projekte të reja për ndërtim.

Shtetet e Bashkuara mbajnë rekordin global me 47 reaktorë të mbyllur, që përfaqësojnë mbi 23,000 MW. Megjithatë, vendi mbetet një "superfuqi bërthamore" me 94 reaktorë aktivë dhe plane për teknologji të gjeneratës së re.

Japonia është kampioni absolut i mbylljeve, me 44 reaktorë dhe një kapacitet prej mbi 35,000 MW të ndalur pas



katastrofës së Fukushima's. Disa janë rikthyer në funksion, por shumica mbeten të mbyllur përgjithmonë.

Strategjitë e vendeve të tjera

Franca ka mbyllur 15 reaktorë, por mbetet lider botëror me 57 aktivë. Politikat e fundit tregojnë synimin për ndërtim të rinj, duke ruajtur dominimin e energjisë bërthamore në miksion kombëtar.

Rusia ka mbyllur 16 reaktorë sovjetikë, por paralelisht ka zgjeruar flotën e saj dhe përdor eksportet bërthamore si instrument gjeopolitik.

Tajvani ka mbyllur gjashtë reaktorë, duke ndjekur një politikë të qartë të daljes nga energjia bërthamore, të nxitur nga kundërshtimi publik.

Kanadaja ka mbyllur gjashtë reaktorë, por strategjia e saj është më shumë rinovim dhe rikthim në funksion sesa dalja nga sektori.

Kina: përjashtimi i madh

Ndryshe nga pjesa tjetër e botës, Kina nuk ka mbyllur asnjë reaktor. Përkundrazi, po ndërton me ritme të shpejta, duke synuar kapacitet prej 150,000 MW deri në vitin 2035. Ky është një tregues i qartë se energjia bërthamore shihet

si një mjet për diversifikimin e burimeve dhe reduktimin e varësisë nga qymyri.

Rikthimi i energjisë bërthamore

Megjithëse dekadat e fundit kanë qenë të mbushura me mbyllje, sot energjia bërthamore po rikthehet në qendër të debatit. Rritja e kërkesës për energji, presioni për dekarbonizim dhe zhvillimet teknologjike po e bëjnë këtë burim energjie sërish tërheqës. Madje, vende si SHBA po shqyrtojnë mundësinë e rikthimit të reaktorëve të mbyllur, si rasti i *Three Mile Island*.

Panorama globale e energjisë bërthamore është e ndarë mes daljes graduale dhe zgjerimit agresiv. Gjermania dhe Japonia përfaqësojnë frikën dhe pasojat e aksidenteve, ndërsa Franca, Rusia dhe Kina përfaqësojnë besimin tek teknologjia dhe nevojën për furnizim të qëndrueshëm.

Pyetja që mbetet është: a do të jetë energjia bërthamore një kapitull i mbyllur, apo një faqe e re në historinë e energjisë botërore?

Ky debat nuk është thjesht teknik apo ekonomik, por edhe politik, shoqëror dhe moral. Në një botë që kërkon gjithnjë e më shumë energji, vendimet për të ardhmen e energjisë bërthamore do të përcaktojnë jo vetëm miksion energjetik, por edhe ekuilibrat gjeopolitikë të dekadave të ardhshme.



Hulumtuesit në Kinë bënë shumë zbulime të mahnitshme, por pak prej tyre kanë qenë aq shqetësuese sa zhvillimi i një lloji të ri gjeneratori që një ditë mund të furnizojë me energji një klasë krejt të re armësh futuriste dhe shkatërruese. Ja çfarë dimë për zbulimin e supozuar.

Ja çfarë dimë për gjeneratorin hipersonik të Kinës
Shkencëtarët në Kinë pretenduan se kanë projektuar një lloj të ri gjeneratori që mund ta shndërrojë gazin e nxehtë që lëviz me shpejtësi super të lartë në rrymë elektrike. Nëse është e vërtetë, teknologjia e thyerjes teknologjike mund të përdoret për të furnizuar me energji armët më të ashpra ushtarake që bota ka parë ndonjëherë.

Zbatime ushtarake
Gjithçka, nga lazerët ushtarakë dhe armët me mikrovalë deri te armët hekurudhore dhe armët me energji pulsuese, përfundimisht mund të fuqizohet nga gjeneratori kinez, sipas “South China Morning Post”, e cila po parafrazonte komentet nga Ndihmës-Hulumtuesi Zhang Xiaoyaun.

“Avantazhe të shumta unike”
Zhang ishte pjesë e grupit të studiuesve shkencorë nga Instituti i Mekanikës pranë Akademisë Kineze të Shkencave që krijuan gjeneratorin, dhe ai shpjegoi në një deklaratë me kolegët e tij se krijimi kishte “avantazhe të shumta unike”.

Efikasitet i lartë
“Ka një kapacitet të madh dhe efikasitet të lartë. Nuk ka nevojë për komponentë të ndërmjetëm të ruajtjes së energjisë”, thuhet në deklaratë sipas “South China Morning Post”.

Transferime të drejtpërdrejta të energjisë
“Energjia mund të transferohet drejtpërdrejt në ngarkesë pa një çelës me fuqi të lartë. Dhe pajisja mund të ndizet shpejt”, vazhdoi deklarata. Por pse do të kishte rëndësi kjo?

Ndërhyrja e satelitëve dhe avionëve
Armët lazer kërkojnë një sasi të madhe energjie elektrike për të shkatërruar një objektiv nga larg, sipas “South China Morning Post”, dhe Kina po zhvillon armë të fuqishme me mikrovalë që mund ta përdorin këtë teknologji për të ndërhyrë në satelitët dhe avionët e armikut.

Një zbulim inovativ
Të dyja armët do të kishin nevojë për energji megavat dhe gigavat që të funksiononin realisht dhe për këtë arsye zhvillimi i një gjeneratori që ka kapacitetin për të krijuar një sasi të madhe energjie elektrike është një zbulim shkencor inovativ.

Pa pjesë rrotulluese
Hulumtuesit vunë në dukje gjithashtu në deklaratën e tyre se gjeneratori i tyre nuk ka asnjë pjesë rrotulluese, e cila

Gjeneratori hipersonik, energjia e së ardhmes



është një nga shumë avantazhet unike që grupi përmendi në lidhje me krijimin e tyre.

Si funksionon
“Popular Mechanics” raportoi për zbulimin shkencor kur u njoftua dhe vuri në dukje se ekipi kinez përdori një shpërthim të kontrolluar për të shndërruar gazin e nxehtë në plazmë që ishte e pasur me jone, të cilat ata i shndërruan në energji elektrike.

Një shifër mbresëlënëse
Ekipi i kërkimit ishte në gjendje të kompresonte gazin e argonit në një shpejtësi mbresëlënëse katërmëdhjetë herë më të madhe se shpejtësia e zërit sipas “Popular Mechanics” dhe prodhoi mbi 212 kilovat rrymë elektrike, duke përdorur 0,26 galonë gaz pasi kaloi nëpër gjenerator.

Më shumë fuqi se çdo gjë tjetër e disponueshme
Nëse nuk jeni inxhinier kimik, atëherë këto shifra mund të mos kenë asnjë vlerë për ju, por janë vërtet mbresëlënëse. “Kjo është fuqi e mjaftueshme për një shpërthim energjie ndryshe nga çdo gjë tjetër e disponueshme tani në një sistem kompakt”, shkroi Tim Newcomb i “Popular Mechanic”.

Gjetjet e publikuara
Gjetjet nga eksperimentet e grupit kërkimor u botuan në Revistën Kineze të Mekanikës Teorike dhe të Aplikuar, dhe studimi vuri në dukje se teknologjia mund të ketë zbatime të shumta civile sipas “South China Morning Post”.

Zbatime civile
Pajisjet e përdorura për energjinë e shkrirjes bërthamore mund të jenë një nga teknologjitë e mëdha të ndikuara nga teknologjia e re e gjeneratorëve dhe gjithashtu mund të përdoren për të gjeneruar sinjale të forta emergjence SOS.

Probleme me teknologjinë?
Megjithatë, gjeneratori ka disa të meta dhe Baba Tamim i “Interesting Engineer” theksoi se një pajisje e tillë vuri në dukje se përdoruesit ushtarakë mund të kenë dyshime në lidhje me pajisjen për shkak të një “vale shoku shpërthimi” nga shpërthimi i kontrollit të saj.

Zhurma nuk do të ndalojë askënd
Tamim vuri në dukje gjithashtu se gjeneratori mund të bënte një zhurmë të lartë që do ta bënte shumë të qartë vendndodhjen e gjeneratorit në fushën e betejës. Por duhet thënë se zhurmat e larta nuk e kanë ndaluar kurrë një forcë ushtarake nga përvetësimi i teknologjive të reja.



MUNDËSI STUDIMI NË AKADEMITË PRESTIGJIOZE USHTARAKE TË SHBA-së



3 KUOTA PËR TË RINJTË QË DUAN TË NDËRTOJNË TË ARDHMEN NË UNIFORMË

Qendra e Personel Rekrutimit hap mundësinë për kandidatët shqiptarë që dëshirojnë të ndjekin studimet në tri nga akademitë më të njohura ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

OFROHEN 3 (TRE) TË DREJTA STUDIMI:

Akademia Ushtarake “West Point”
1 kuotë studimi

Akademia Ushtarake Detare e SHBA-së
1 kuotë studimi

Akademia Ushtarake e Forcave Ajrore të SHBA-së
1 kuotë studimi

NJË HAP DREJT NJË KARRIERE NDËRKOMBËTARE

Studimi në akademitë ushtarake të Shteteve të Bashkuara ofron një mundësi të veçantë për formim akademik, ushtarak dhe profesional, duke i përgatitur të rinjtë për sfidat e sigurisë dhe mbrojtjes së të ardhmes.

AFATI I APLIKIMIT

Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Qendrës së Personel Rekrutimit deri më 30 shtator 2026.

MOS E HUMB KËTË MUNDËSI!

Nëse ke ambicie, disiplinë dhe dëshirën për t'i shërbyer vendit, rruga jote drejt një formimi të nivelit të lartë mund të nisë sot.

APLIKO! PËRGATITU! SHËRBE! ARRI MAJAT!

Për informacion të mëtejshëm mbi kriteret dhe procedurat e aplikimit, kandidatët mund të drejtohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit dhe të konsultojnë faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

****FORCAT E ARMATOSURA TË SHQIPËRISË:
NJË KARRIERË. NJË MISION. NJË E ARDHME****